



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**

**“Kitarë dhe Mësuesi”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr.Valentina Haxhiymeri
2. Prof.Asoc.Dr. Robert Gjedia

Shtator 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofruar nga**  
**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Interpretimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr. 397, datë 10/08/2011 “Për hapjen e programeve të studimeve te ciklit të dytë “Master Profesional”, “Master i Shkencave” dhe “Master i Arteve të Bukura” në Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve të Tiranës”, pika 2, “Për hapjen e programit të ciklit të dytë në Kitarë, në përfundim të të cilit lëshohet diploma universitare “Master Profesional” në “Kitarë”. (Dokumenti 61/ II.1.5.3 urdhri Nr.397, date 10.08.2011.pdf)
b	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr.512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve”. (Dokumenti 1/1. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs).
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.159, datë 2018-09-19 “Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, të Universitetit të Arteve”. (Dokumenti 1/2. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs).
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i II- të
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Raporti midis PAE dhe PAK është 50 (57.5%) me 37 (42.5%).
18	Numri i studentëve:	Numri i studentëve të regjistruar për vitin akademik: ➤ 2019-2020 janë 11 studentë ➤ 2020-2021 janë 9 studentë ➤ 2021-2022 është 1 student
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm u orientua së pari nga shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit të Arteve (në vijim UA) dhe së dyti sipas aktiviteteve të realizuara sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet UA dhe ASCAL.

Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” i licencuar me *Urdhrit të MASR* Nr. 512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve” (*Dokumenti 1/1. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs*). Programi i studimit me kohë të plotë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” i përket ciklit të dytë të studimeve dhe ofrohet me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, me 120 ECTS.

Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet si një prej programeve të studimit në Departamentin e Interpretimit, të Fakultetit të Muzikës së Universitetit të Arteve, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Urdhër Nr. 512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve” (*Dokumenti 1/1. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs*), ku në përfundim të ciklit të studimit dy vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare “Diplomë Master Profesional” në “Kitarë dhe Mësuesi”.

### **Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.**

Ky program i ciklit të dytë “*Master Profesional*” përmban gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2021-2022 është 1 student
- Për vitin akademik 2020-2021 është 9 studentë
- Për vitin akademik 2019-2020 është 11 studentë

Gjithsej të diplomuar 7 studentë

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

*Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë nga ana e programit të studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc.Dr. Valentina Haxhiymeri dhe Prof.Asoc. Dr. Robert Gjedia dhe gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxheret teknike të ASCAL, Msc. Endra Velaj dhe Msc. Rajna Lila.

***Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:***

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve” (*Dokumenti 1/1. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs*).
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

### **Aktivitet kryesore të realizuara**

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

**Analiza e të dhënave parësore.** Të dhënat parësore janë marrë nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (shtator 2022) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit, i cili ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të Universitetit të Arteve, etj.

**Analiza e të dhënave dytësore.** Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit, të Studentëve, Këshillimit dhe Karrierës, Alumni.
- Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Takim me Përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore
- Vizitë në Sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe në bibliotekë
- Takim përfundimtar me Përgjegjësën e Departamentit

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm.

Nga ana tjetër, si pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, u realizua:

### **Vëzhgimi i mjediseve**

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm vëzhgoi mjediset mësimore që ishin në dispozicion të programit të studimit, si: auditorë, laboratorë të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve dhe literaturës së bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB dhe evidencat është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

**Lënda:** Memo / Raporti i vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, Universiteti i Arteve, Tiranë.

**Drejtuar:** Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Arteve, Tiranë.

Referuar shkresës së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Arteve, Tiranë, me Nr. 697/1 Prot., datë 23.08.2023, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në përgjigje të procesit të rishikimit të përmbajtjes së Draft/Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi me vëmendje të posaçme momentet e diskutueshme të përshkuara në këtë shkresë dhe konkludoi si më poshtë:

1. Përsa i përket përgjigjes lidhur me standardin 1.3, kriteri 4, GVJ vlerëson informacionin e përcjellë nga institucioni për certifikimin/kreditimin e pedagogëve dhe studentëve të angazhuar në veprimtari artistike/shkencore, të realizuara në kuadër të bashkëpunimeve me institucione dhe organizma të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit. Por lidhur me këtë kriter të standardit, GVJ sqaron se rekomandimi sjell në vëmendje çështjen e dokumentimit me shkrim të *raporteve analitike periodike mbi përfitimet nga bashkëpunimet*, të cilat përgatiten nga njësia përgjegjëse për realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim.

Rekomandimi i GVJ për këtë çështje mbetet i pandryshuar.

2. Për standardit II.1, kriteri 1, GVJ sqaron se analiza e elementeve të programit të studimit është bazuar në emërtimin e tij “Master Profesional”, dhe jo “Master i Arteve”.

Emërtimi i programit të studimit “Master Profesional” në “Kitarë dhe Mësuesi”, është përcaktuar qartë në dokumente të tilla si:

- 1) Urdhër Nr.512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve”. (*Dokumenti 1/1. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs*;
- 2) Urdhër Nr.159, datë 19.09.2018 “Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", të Universitetit të Arteve”. (*Dokumenti 1/2. MP Kitarë dhe Mësuesi / PM Guitar and Teaching, Rubrika Study Programs*).

GVJ nuk ka ndeshur dokumente të tjera që mbështesin pretendimin e institucionit lidhur me emërtimin “Master i Arteve” për programin e studimit të marrë në vlerësim, ndaj vendosi që rekomandimi për këtë kriter të mbetet i pandryshuar.

3. Për standardin II.1, kriteri 3, GVJ sqaron se praktika profesionale e cila përbëhet nga praktika mësimdhënëse (6 kredite) dhe praktika artistike (5 kredite), në total, përfshin 11 ECTS, ose 9.2% të krediteve të programit të studimit, nga 10% të përcaktuara për këtë kategori në VKM Nr. 41/2018 (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019, dhe me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021). Praktika profesionale kategorizohet në grupin e lëndëve të kategorisë D (lëndë plotësuese) dhe rezulton me *0.8% kredite më pak* se përcaktimet e VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori.

GVJ vendosi që rekomandimi për këtë kriter të mbetet i pandryshuar.

4. Për sa më sipër, GVJ vendosi që konkluzioni lidhur me Standardin II.1, të mbetet i pandryshuar.
5. Bazuar në komentet e institucionit lidhur me standardin II.3, kriteri 2, GVJ arsyetoi që të hiqet nga përmbajtja e RVJ paragrafi *“Duke qenë se gjenden 9 lëndë me zgjedhje dhe ngarkesa mësimore është pasqyruar për secilën prej tyre pavarësisht sa lëndë duhet të zgjedhë për çdo semester një student për të fituar 4 kredite, mund të krijojë konfuzion lidhur me vlerësimin e ngarkesës mësimore në total të pasqyruar në planin mësimor”*, por të mbetet paragrafi *“GVJ vëren se ndarja e lëndëve me zgjedhje ka nevojë të shoqërohet me informacion shtesë/shënim sqarues në fund të planit mësimor”*.

Në vijim, GVJ vlerëson qëndrimin e institucionit për të korrigjuar në të ardhmen gabimin teknik në Planin Mësimor.

6. Lidhur me standardin II.3, kriteri 4, GVJ merr në konsideratë sqarimin e institucionit për rastin e versionit të printuar të syllabusit të paplotë dhe vendosi që të hiqet nga konteksti fjalia *“Por, gjendet ndonjë rast tjetër kur syllabusi rezulton i paplotë. (fq. 24-25). (Dokument 59/II.1.1.8 SYLLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf)*.
7. Për sa më sipër, GVJ vendosi që vlerësimi lidhur me Standardin II.3/Konkluzione, të ndryshohet nga *“Përbushet kryesisht”*, në *“Përbushet plotësisht”*.
8. Përsa i përket Standardit II.4, kriteri 2, GVJ vlerëson dhe mirëpret në të ardhmen angazhimin e institucionit për të korrigjuar gabimin teknik në Planin Mësimor, të cilësuar si lapsus.

Në vijim, GVJ vlerëson komentën e institucionit për natyrën specifike të programit të studimit të lidhur me elementin e ngarkesës mësimore që realizohet në masën dy herë më shumë jashtë auditorit sesa brenda në auditor. Megjithatë, pavarësisht specifikës së programit të studimit të marrë në vlerësim, GVJ vëren se kjo situatë mund të perceptohet si një mbingasë për studentin me punë individuale jashtë auditorit.

Nga ana tjetër, analiza e të dhënave të Planit Mësimor tregoi se nuk është pasqyruar shuma e orëve mësimore/javore për çdo semester dhe shuma e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit.

GVJ vendosi që rekomandimi për këtë kriter të mbetet i pandryshuar.

9. Bazuar në përgjigjen e institucionit për *përbushjen* e Standardit II.4, kriteri 3, ku shprehimisht sqarohet se *“Plani mësimor detajohet në Syllabuset e lëndëve që e përbëjnë këtë plan mësimor”*, GVJ rishqyrtoi vlerësimin e tij për këtë standard/kriter dhe vendosi të heqet nga përmbajtja e RVJ, teksti në vijim: *Megjithatë, GVJ sugjeron që të rishikohet Plani Mësimor i programit të studimit të marrë në vlerësim, me qëllim që të sigurohet informacioni i nevojshëm lidhur me sasinë e orëve mësimore dedikuar leksioneve/seminareve/ushtrimeve apo formave të tjera mësimore të parashikuara për një lëndë/modul.*
10. Lidhur me Standardin II.4, kriteri 4, GVJ sqaron se analiza e elementeve të programit të studimit është bazuar në emërtimin e tij *“Master Profesional”* në Kitarë dhe Mësuesi, dhe

jo "Master i Arteve". (Për më tepër, lexo pikën 2 të kësaj shprese).

GVJ vendosi që rekomandimi për këtë kriter të mbetet i pandryshuar.

11. Duke marrë në konsideratë komentet e institucionit dhe rishikimet e përshkruara më lartë, GVJ vendosi të ndryshojë përmbajtjen e Standardit II.4/ Konkluzione, duke hequr tekstin në vijim: "*Pasqyrimi i sasisë së orëve mësimore dedikuar leksioneve / seminareve / ushtrimeve apo formave të tjera mësimore të parashikuara për një lëndë/modul*". Rekomandimet e tjera mbeten të pandryshuara.

Së fundi, duke vlerësuar si serioz dhe të dobishëm angazhimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Arteve, Tiranë, në procesin e rishikimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, grupi i vlerësimit i uron suksese të mëtejshme në përpjekjen e tij për të përmirësuar cilësinë dhe arritur standardet e dëshiruara.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

Prof.as.Dr. Valentina Haxhiymeri  
Prof.as.Dr. Robert Gjedia

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi L1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti i Arteve (UA) në Tiranë është një institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit artistik/shkencor, veprimtarive krijuese artistike dhe profesionale. UA ofron programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. (Neni 9, pika 1, dhe 2 e Statutit të UA, 2021; Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Universiteti i Arteve (UA) ofron programe studimi në përputhje me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Ky standard gjen shprehje në Statutin e UA (2021), Neni 7 i tij “Zhvillimi i veprimtarisë”, Pika 2, ku deklarohet se “UA vendos në bazë të mësimdhënies traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore dhe ato evropiane” (fq. 7). (Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Sipas Rregullores së UA (2021), Neni 48, Pika 2, shprehet se “UA ofron programe të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite”. (Dokumenti 23/ I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF)</p> <p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në UA (2021)”, Neni 1 i saj, specifikohet se: <i>Programet e ciklit të dytë të studimeve janë programe universitare të formimit artistik të cilat ofrojnë studime edhe në fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndët e artit pranë institucioneve të arsimit parauniversitar të ciklit të ulët dhe të ciklit të mesëm.</i> (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë, përfshi edhe programin Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet nga Departamenti i Interpretimit (DI), Fakulteti i Muzikës (FM), në Universitetin e Arteve (UA) (Neni 1, Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>



<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, të shprehur në Statutin e UA, 2021.</p> <p>Sipas Statutit të UA (2021), Neni 4 i tij “Misioni”, deklarohet se “UA ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës, si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/ shkencor; b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhetë përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; d) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; k) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë dhe qytetërimit; etj”. (Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 2, deklarohet se “Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, nëpërmjet veprimtarive formuese, teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor/artistik/kulturor shqiptar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kitaristë të kualifikuar për të performuar në të gjitha gjinitë e muzikës si solistë, pjestarë të asambleve, si dhe pjestarë të grupeve të ndryshme dhe band-eve të muzikës modern;</li> <li>- Mësues/instruktorë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar;</li> <li>- Pedagogë për lëndët kitarë, muzikë dhime, deshifrashë dhe prane FM të UART.</li> <li>- Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore.</li> </ul> <p>Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme torike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dokumentin “Plani strategjik i UA 2018-2025” ku ka shplosur misionin dhe visionin e tij për të ardhmen, si vijon:</p> <p><b>Misioni:</b> Universiteti i Arteve ka për mision edukimin profesional artistik, realizimin e projekteve artistike dhe shkencore në fushën e muzikës, artit skenik, artit figurativ dhe të aplikuar. Misioni i saj lidhet me formimin artistik duke u mbështetur fort në ruajtjen e traditës së mëparshme si dhe garantimin e nivelit të lartë dhe cilësor në të gjitha fushat ku ky institucion operon.</p> <p><b>Vizioni:</b> Universiteti i Arteve synon të mbetet qendra më e madhe dhe më cilësore e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit, dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së artit. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin dhe projektet artistike, ajo kërkon të përgatisë jo vetëm artistë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Plotësimi i studimeve në vazhdimësi duke e bërë të mundur për ta, të tre ciklet e formimit universitar. Universiteti i Arteve duhet ta</p>

	<p>shohë edhe më tej vetveten në kuadrin e një perspektive të gjerë ndërkombëtare duke shpalosur individualitetin e vet në gjuhë dhe kulturë. (Dokumenti 22/I.I.1.3.3 VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf)</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UA (2018-2025), në zbatim të Statutit të UA, Neni 99, 100, 101 dhe 102 (Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF), dhe Rregullores së Universitetit të Arteve, Neni 62, 63, 64 dhe 65 (Dokumenti 23/I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF), si dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit të përcaktuara sipas VKM-së nr. 234, datë 23.3.2011, “Për krijimin e Universitetit të Arteve (Dokumenti 93/VKM nr. 234, datë 23.03.2011, “Për krijimin e UART”.pdf) dhe VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021, Pika 1 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve (në vijim, UART), si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve, krijuar me vendimin nr.234, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Universitetit të Arteve” (Dokumenti 92/VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> <p>Referuar RVB (2022) për kriterin 4, mësohet se programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” mban në konsideratë dhe mbështetet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (Dokumenti 13/I.I.1.1.6 Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020.pdf).</li> <li>- Parashikimet e Draft Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, me fokus në 5 fusha kyçe: <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Cilësia në arsimin e lartë</li> <li>2) Integritetin dhe transparencën</li> <li>3) Studentët</li> <li>4) Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë</li> <li>5) Shërbimet digjitale</li> </ol> </li> </ul> <p>Në dokumentin “Plani strategjik i Universitetit të Arteve 2018-2025”, Pika 1.1, institucioni thekson se “<i>Vizioni ynë strategjik është integrimi de jure rajonal, evropian dhe global, duke çuar më tej atë traditë që de facto e bën Universitetin e Arteve një nga IAL-të shqiptare konkurrencte me produktin e saj në tregun evropian dhe botëror. Universiteti i Arteve do të mbështetet gjithnjë e më tepër në tre boshte kryesore të cilët janë:</i></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukimi</li> <li>• Krijimtaria artistike dhe kërkimi shkencor</li> <li>• Produksioni artistik dhe menaxhimi i tij</li> </ul> <p>Universiteti i Arteve operon në një treg global, duke konkurruar brenda vetes dhe brenda vendit për t'i shërbyer atyre që duan të shkollohen në Shqipëri si dhe duke plotësuar të gjitha nevojat e tregut të shkollimit artistik me afrimin e politikave konkurruese me tregun vendas dhe me atë të huaj. Universiteti i Arteve do të punojë për të ndërtuar dhe zgjeruar edhe më tej fushën e veprimtarisë së saj, në mënyrë që të ofrojë mundësinë e zgjedhjes për të gjithë ata që kanë talentin dhe dëshirën për të studiuar dhe thelluar studimet në fushën e artit". (Dokumenti 14/I.I.1.1.7 Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf).</p> <p>Sipas dokumentit "Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi" (2022)", Neni 1, deklarohet se "Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizur për t'ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të të gjitha cikleve". Neni 2 i këtij dokumenti specifikon se "Ky program synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme torike dhe aftësitë e duhura praktike për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. Plani mësimor i këtij programi studimi zhvillohet në vazhdimësi të programit të ciklit të parë Bachelor në Kitarë Klasike, dhe në aspektin përmbajtësor, është strukturuar në mënyrë të tillë që të krijojë mundësinë e lidhjes logjike mes lëndëve përbërëse. Njëherazi, programet e lëndëve, sikurse dhe vetë plani mësimor, janë hartuar në ngjashmëri me të njejtat lëndë në vendet e zhvilluara, kryesisht në ato të Europës Perëndimore". (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>						
<b>Konkluzione</b>	<p>Universiteti i Arteve Tiranë (UART) demonstroi se ofron programe studimi, përfshi edhe programin e studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", në përputhje me vizionin, misionin, qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së tij, e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UART.</p>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="560 1592 775 1675"></th> <th data-bbox="775 1592 970 1675">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="970 1592 1185 1675">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="560 1675 775 1720"></td> <td data-bbox="775 1675 970 1720"></td> <td data-bbox="970 1675 1185 1720" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**Standardi L2****Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.****Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Universiteti i Arteve Tiranë (UART) përfshin në trashëgiminë e vetë të vyer, eksperiencën e shkëlqyer të Konservatorit të Muzikës të krijuar në vitin 1962, Institutit të Arteve të Bukura të krijuar në vitin 1959, Shkollës së Teatrit të krijuar në vitin 1959, të cilat së bashku krijuan Institutin e Artit të Arteve në 1966, dhe që më pas, në vitin 1991, u riemërua Akademia e Arteve, dhe prej vitit 2011 e deri më sot, ai emërtohet Universiteti i Arteve. UART përmbledh një tërësi vlerash artistike, kulturore, akademike dhe shoqërore, të krijuara dhe formësuara prej një kohe të gjatë dhe prej një mori brezash të njëpasnjëshëm të pedagogëve, studentëve, artistëve dhe personaliteteve nga më të shquarat në Shqipëri. (Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti\_uart\_2021.PDF, fq. 4).

Universiteti i Arteve përfaqëson një strukturë të integruar të përbërë nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë, si më poshtë:

- Fakulteti i Muzikës
- Fakulteti i Artit Skenik
- Fakulteti i Arteve të Bukura

Fakulteti i Muzikës (FM) përbëhet nga 3 departamente:

- Departamenti Interpretimit
- Departamenti Kanto
- Departamenti Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore

(Neni 11, Pika 4, Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti\_uart\_2021.PDF, fq. 9).

Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Interpretimit (DI), në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). (Neni 1, Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).

Fakulteti i Muzikës (FM) dhe Departamenti i Interpretimit (DI) demonstrojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit.

Referuar të dhënave në tabelën përkatëse për Personelin Akademik me kohë të plotë, viti akademik 2021-2022 (Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategoria: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë), mësohet se FM ka gjithsej 152 personel akademik, nga të cilët **84 Personel Akademik Efektiv (PAE)**, me nivel kualifikimi si më poshtë:

- 17 Prof. /Prof. Dr.
- 17 Prof. Asoc. Dr.
- 13 Dr. / Doc.
- 37 Msc.

	<p>dhe <b>68 Personel Akademik me Kontratë (PAK)</b> me nivel kualifikimi si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 Prof. /Prof. Dr.</li> <li>- 1 Prof. Asoc. Dr.</li> <li>- 6 Dr. / Doc.</li> <li>- 54 Msc.</li> </ul> <p>Raporti midis PAE dhe PAK është 84 (55.3%) me 68 (44.7%), në favor të PAE.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Interpretimit (DI) i cili ka në përgjegjësi realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, ka gjithësej <b>87 personel akademik</b>, për vitin akademik 2021-2022, ku <b>50 PAE</b>, nga të cilët <b>11 Prof. /Prof.Dr., 12 Prof.Asoc.Dr., 10 Dr./Doc</b>, dhe <b>17 Msc</b>, si dhe <b>37 PAK</b>, nga të cilët <b>1 Prof. /Prof.Dr., 1 Prof.Asoc.Dr., 0 Dr./Doc</b>, dhe <b>35 Msc</b>. (Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategoria: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë).</p> <p>Raporti midis PAE dhe PAK është 50 (57.5%) me 37 (42.5%), në favor të PAE.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 1, shprehet se Fakulteti i Muzikës (FM) është njësi kryesore e Universitetit të Arteve Tiranë (UART) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike – kërkimore – shkencore në fushën e Muzikës. Në Nenin 4, pika 1 të këtij dokumenti, përcaktohet se “<i>FM ka për qëllim kryesor organizimin e procesit të mësimdhënies, dhe artistik/ shkencor, si kurse dhe zhvillimin dhe përhapjen në nivele më të larta intelektuale, të dijes në fushën e Muzikës</i>”. Ndërsa, në pikën 5 specifikohet se “<i>FM kujdeset për cilësinë e mësimdhënies në arsimin e lartë në të gjitha ciklet dhe nivelet e parashikuara me ligj, vepron në fushën e formimit artistik, kulturor/shkencor dhe profesional dhe synon gjithashtu formimin dhe aftësimin e personelit të tij</i>”. Në Nenin 21 të Rregullores përcaktohet se “<i>FM ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve (në vijim, UART), si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve në RSH. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)</i>”. Në nenin 26, pika 4 e Rregullores, deklarohet se “<i>Programet e studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” u ofrojnë të diplomuarve me një diplomë universitare së paku “Bachelor” arsimim dhe trajnim të mëtjshëm profesional. Këto programe realizohen me 120 kredite dhe zgjatja e tyre normale është 2 vite akademike, në përfundim lëshohet diploma “Master Profesional”</i>”. (Dokumenti 41/LL.3.1.12 VSA</p>

	<p>36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Interpretimit (DI), në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizur për t’ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të të gjitha cikleve. Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me nivelin 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. (Neni 1, Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare. pdf, 2022).</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FM, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Departamentit të Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 1, shprehet se “<i>Departamenti Interpretimit është një nga njësitë bazë të Fakultetit të Muzikës (FM) në Universitetit të Arteve Tiranë (UART) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike – kërkimore – shkencore në fushën e Muzikës</i>”. (Dokumenti 88/VSA_45 Rregullore e Departamentit Interpretim FM.pdf).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Interpretimit (DI), në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). (Neni 1, Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet <b>pjesërisht brenda profilit specifik të IAL-së, duke iu referuar Statusit të veçantë që gëzon Universiteti i Arteve</b>, dhe për rrjedhojë Fakulteti i Muzikës, Departamenti Interpretimit të cilët janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim. (Dokumentit VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH). Sipas Statutit (2021), Neni 9, pika 1, deklarohet se “<i>Universiteti i Arteve (UA) në Tiranë është një institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit artistik/shkencor, veprimtarive krijuese artistike dhe profesionale</i>”. (Dokumentit 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës</i>” (2021), Neni 21 “<i>Programet e studimit</i>”, Pika 1, shprehet se “<i>Fakulteti i Muzikës ofron programe studimi</i>”</p>

të ciklit të parë dhe të dytë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021 "Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH". Neni 26 i kësaj rregulloreje, pika 1, shprehet se "Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë, në... Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi " (Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).

Fillimisht, programi i studimi është ofruar nga UA/FN vetëm në profilin Master Profesional në "Kitarë", me 90 kredite dhe kohëzgjatje normale 1,5 vite akademike (një vitë e gjysmë) (Dokumenti 61/ II.1.5.3 Urdhri Nr. 397, date 10.08.2011.pdf). Në vitin 2019, me Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019 "Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve", dhe Urdhër Nr.159, datë 19.09. 2018 "Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", të Universitetit të Arteve", programi i studimit i marrë në vlerësim u riorganizua në Master Profesional me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), si dhe përfshiu në emërtim edhe fushën e Mësuesisë, duke cilësuar formën e regjistrimit të diplomës "Master Profesional" në Kitarë dhe Mësuesi. (Dokumenti Urdhër Nr.512, datë 2019-10-24; Urdhër Nr.159, datë 2018-09-19).

Sipas institucionit, një nga arsytet për riorganizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, është rritja e kërkesës për mësues të interesuar për master si rezultat i reformave ligjore dhe dispozitave shoqëruese të cilat kushtëzojnë aplikantët t'i nënshtrohen procedurave për konsolidimin e mësuesisë si profesion i rregulluar me ligj. (Dokument 96/Studimi i Tregut FM me vula.PDF, fq. 1).

Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi" (2022), Neni 1, përcaktohet se "Programi i studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi" ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Interpretimit (DI), në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizur për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të të gjitha cikleve". (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf, 2022).

Për të garantuar cilësinë e programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, UA/FM/DI dëshmon se ka rekrutuar PAE dhe PAK të kualifikuar në fushën e psiko-pedagogjisë / mësuesisë, si dhe ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sikurse

	DAR/ZAV në disa rrethe të vendit për të realizuar praktikat profesionale të studentëve. (Dokumenti 20/I.I.1.1.16 Jeteshkrimet e PE te DI. pdf; Dokumenti 55/I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf; Dokumenti 56/I.I.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.pdf; Dokumenti 59/ II.I.1.8 SYLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf).								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar RVB (2022), mësohet se “ <i>Institucioni i arsimit të lartë nuk ofron aktualisht trajnime të drejtpërdrejta profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” në bashkërendim me punëdhënësit potencialë... Mundësitë që afrohen për trajnime profesionale të studentëve të diplomuar, lidhen me:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- produksione artistike të ofruara nga institucionet publike të fushës së muzikës;</li> <li>- produksione artistike të ofruara nga sektori jopublik si OJF;</li> </ul> <i>të cilat praktikisht realizojnë trajnime praktike të modelit “learning by doing”, ku shkëmbimet e përvojave me grupet e profesionistëve, shërbejnë si një shkollë e trajnim i vazhdueshëm për të rinjtë Kitaristë pas diplomimit”</i> (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf). Nga vizita në institucion, GVJ konfirmoi se UA/FM/DI ruajnë kontaktet me të diplomuarit e tyre ndër vite, të cilët janë punësuar brenda apo jashtë vendit, si dhe planifikojnë dhe organizojnë së bashku veprimtari artistike/kulturore e shkencore që kanë si qëllim shkëmbimin e përvojës së fituar, ndarjes së ideve inovative dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive, aftësive dhe kompetencave në fushën e muzikës. (Vizita dy ditore në IAL, datë 22-23 nëntor, 2022).								
<b>Konkluzione</b>	Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, është pjesërisht në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Muzikës dhe Departamentit të Interpretimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit të orfuar. Por, për të garantuar cilësinë e programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, UA/FM/DI dëshmon se ka rekrutuar PAE dhe PAK të kualifikuar në fushën e psiko-pedagogjisë / mësuesisë, si dhe ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sikurse DAR/ZAV në disa rrethe të vendit për të realizuar praktikat profesionale të studentëve.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="width: 25%;"><b>Përmbushet plotësisht</b></td> <td style="width: 25%;"><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td style="width: 25%;"><b>Përmbushet</b></td> <td style="width: 25%;"><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Standardi I.3</b>	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	UA/FM/DI demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UA (2021), dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet



<p>frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi”.</p> <p>Në Statutin e UA (2021), Neni 1, përcaktohet se “Ky statut ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Arteve, strukturave përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrative dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e UA-së”. (Dokumenti 21/I.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Nga Statuti i UA (2021) buron Rregullore e Universitetit të Arteve (2021) e cila në Nenin 2, përshkruan se “Qëllimi i kësaj Rregullore është të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator, të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore, artistike/kërkimore -shkencore dhe administrative të fakulteteve dhe njësive të tjera përbërëse të UA-së”. (Dokumenti 23/ I.1.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF).</p> <p>Bazuar në këto dokumente kyçe të funksionimit në nivel institucional, janë gjeneruar dokumentet e tjera rregullore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti, programi studimor, etj., si: Kodi i Etikës, Rregullore e NJSBC, Rregullore e bibliotekës, Rregullore e secretaries mësimore, Rregullore e fakultetit, Rregullore e departamentit, Rregullore e programit të studimit, etj., të cilat përbëjnë themelin për të siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (Referuar tërësisë së dokumenteve rregullatore të UA/FM/DI, Urdhrave dhe akteve të tjera administrative, të pasqyruara në e-ASCAL për qëllime akreditimi).</p> <p>Në bazë të përcaktimeve të Statutit të UART dhe Rregulloreve përkatëse, në përfundim të çdo viti akademik realizohen analizat vjetore të punës mes njësive dhe personelit. Raporti Analizës Vjetore (2021-2022) i Departamentit të Interpretimit, drejtuar Dekanit të Fakultetit të Muzikës, përbën një praktikë të mirë pune dhe është një tregues i bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive, dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (Dokumentit 44/I.1.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi</p>	<p>Në Statutin e Universitetit të Arteve (2021), Neni 6, shprehet se “UA ka të drejtën ... (c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas dhe të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse,</p>

<p>me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>artistike-kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjëshme; (e) për të vendosur marrëdhënie me institucione e organizata vendase apo të huaja, publike dhe jo publike, me organizata biznesi, OJF, etj., lidhur me bashkëpunimin institucional, artistik, profesional e shkencor, për shkëmbimin e përvojave, të personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe të studentëve, për praktikat e studentëve, projekte të përbashkëta, etj..” (Dokumenti 21/I.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p>
	<p>Përmes akt-marrëveshjeve, letters of intent, dhe dokumenteve të tjera bashkëpunuese ndërinstucionale, UA/FM dëshmon se për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me aktorë të biznesit vendës. (Dokument I.I.3.2.1 UART AGDER marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107; I.I.3.2.2 UART CSM VIGO marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107; I.I.3.2.3 UART RCSM GRANADA marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107; I.I.3.2.5 MOU UART CNSMDP; I.I.3.2.6 UART CSM VIGO intent letter për Diplomat e përbashkëta; I.I.3.2.7 UART DAMS UNIBA intent letter për Diplomat e përbashkëta; I.I.3.2.8 UART UNI TOR VERGATA Marrëveshje për Doktorata të Përbashkëta; I.I.3.2.9 Informacion zyrtar në faqen zyrtare të UART për TAP dhe AICS; I.I.3.2.10 Informacion zyrtar në faqen zyrtare të UART për Pianon e dhuruar prej financimit në modelin crowdfunding).</p>
	<p>Në RVB (2022) institucioni përshkruan se marrëveshjet ndërinstucionale të nënshkuara u përkasin dy kategorive:</p>
	<ol style="list-style-type: none"> <li>1) <i>marrëveshje me institucione homologe dhe</i></li> <li>2) <i>marrëveshje me aktorë biznesi brenda ose jashtë vendit.</i></li> </ol>
	<p>Kategoria e parë e marrëveshjeve me institucione homologe brenda e jashtë vendit përfshin:</p>
	<ol style="list-style-type: none"> <li>a) <i>Marrëveshje bashkëpunimi ndërinstucional në kuadër të Programit Erasmus+. KA107, nga viti akademik 2017-2018 e deri në 2021-2022:</i></li> </ol>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- University of Agder - Norvegji</li> <li>- Conservatorio Superior de Musica de Vigo – Spanjë</li> <li>- Real Conservatorio Superior de Musica “Victoria Eugenia” – Spanjë</li> <li>- Conservatorio di Musica “S. Giacomantonio” Cosenza – Itali</li> <li>- Conservatorio di Musica “G. Tartini” Trieste – Itali</li> </ul>
	<ol style="list-style-type: none"> <li>b) <i>Memorandume mirëkuptimi midis:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Universitetit të Arteve – Fakulteti i Muzikës Tiranë me Conservatoire National Superior de Musique et Dance de Paris, Francë</li> </ul> </li> </ol>
	<ol style="list-style-type: none"> <li>c) <i>Marrëveshje për Diploma të Përbashkëta:</i></li> </ol>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Universiteti i Arteve – Fakulteti i Muzikës Tiranë me Conservatorio Superior de Musica de Vigo – Spanjë (Bachelor dhe/ose Master)</li> <li>- Universiteti i Arteve me Dipartimento Arti, Musica, Spettacolo – Università “Aldo Moro” Bari, Itali (Bachelor)</li> <li>- Universiteti i Arteve me Università “Tor Vergata” Roma, Itali (PHD në Shkenca të Trashëgimisë Kulturore)</li> </ul> <p>Kategoria e dytë e marrëveshjeve me aktorë të biznesit vendas dhe të huaj përfshin:</p> <p>a) <i>Marrëveshje e drejtpërdrejtë</i> për pjesëmarrje të biznesit vendas apo të huaj në investimet madhore të Universitetit të Arteve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Pjesëmarrja financiare</i> e kompanisë <i>Trans Adriatic Pipeline në Rikonstruksionin dhe Restaurimin e Sallës së Madhe të Koncerteve</i> të Universitetit të Arteve</li> <li>- <i>Pjesëmarrje dhe asistencë teknike e Agjencisë Italine për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Restaurimin e Sallës së Madhe të Koncerteve</i> të Universitetit të Arteve.</li> </ul> <p>b) <i>Marrëveshje jo të drejtpërdrejta</i> (indirekte) për pjesëmarrje të biznesit vendas apo të huaj në produksionet artistike të Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Crowdfunding</i> për blerjen e një pianoje koncertale për Sallën e Madhe të Koncerteve të UART.</li> </ul> <p>(Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, UA/FM/DI dëshmon se ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione të fushës përkatëse në sistemin arsimor, për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e temave kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Marrëveshjet e nënshkruara nga UA për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” janë me Drejtoritë e Përgjithshme të ZVA Tiranë, Vlorë, Korçë, Elbasan, Berat dhe Kurbin, ku përshkruhen edhe kushtet e bashkëpunimit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në mësimdhënie. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf; Marrëveshje me ZVA Vlorë).</p> <p>Një marrëveshje tjetër që përfshin DI, përgjegjëse për realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, është MK-TKOB-UART Pakti për Universitetin. Ky projekt siguron angazhimin e përkohshëm të studentëve Kitaristë në sezone koncertale të institucioneve/organizatave jofitimprurëse. Dokumenti 55/ I.I.3.3.1 Tabela 5 Marrëveshjet.pdf).</p> <p>Gjithashtu, UA/FM/DI ka realizuar bashkëpunime në kuadër të projekteve Erasmus+ për mobilitet të studentëve lidhur me realizimin e praktikave profesionale artistike, <i>internship-it</i> pranë institucioneve artistike</p>

	<p>homologë të Spanjës. (Dokumenti 57/I.I.3.3.3 KLevis Delibashi Internship LA.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se në të ardhmen institucioni synon që të zgjerojë bashkëpunimet në kuadër të projekteve Erasmus+ me qëllim krijimin e mundësisë së bursave Erasmus+ për studentët.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse (DI) nuk dëshmon se ka hartuar raporte analitike periodike të adresuara drejtpërsëdrejti përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaron se "... sipas raportit analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit ndërishtitucional rezultojnë se është aprovuar dhe <b>realizuar 1 mobilitet semestral</b> për studentët master në <b>Kitarë dhe Mësuesi</b>, në Norvegji gjatë vitit 2021-2022". Ky fakt statistikor pasqyrohet në tabelën me titull "UNIVERSITETI I ARTEVE / ERASMUS+ ICM DATA - ACADEMIC YEARS / 2017-2018/ 2018-2019/2019-2020/" (Dokumenti 58/ I.I.3.4.1 Universiteti i Arteve - Statistikat ICM - shtator 2022.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se megjithëse nuk ka një raportim analitik me shkrim, Departamenti Interpretimit diskuton rreth mbarëvajtjes së bashkëpunimeve, rast pas rasti, sikurse bashkëpunimet në kuadër të praktikave profesionale, si dhe analizojnë rezultatet e tyre gjatë mbledhjes së analizës vjetore.</p> <p>Megjithatë, lidhur me këtë kriter, <i>GVJ i sugjeron</i> njësisë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit që të dokumentojë me shkrim raportet analitike periodike mbi përfitimet nga bashkëpunimet me aktorë, institucione dhe organizma të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UART/FM/DI dëshmon se ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, organizata, aktorë të biznesit, vendase dhe të huaja në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. GVJ sugjeron që Departamenti Interpretimit të dokumentojë me shkrim raportet analitike periodike mbi përfitimet nga bashkëpunimet.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, “Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, përcakton se “Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</p> <p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, dhe i ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Pika 2 e tij, shprehet se: <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</li> <li>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>c) rezultatet e të nxënit (objektivat formues) dhe kompetencat profesionale;</li> <li>ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>dh) planin mësimor;</li> <li>e) kuotat e pranimiit dhe grupet mësimore;</li> <li>ë) programin lëndor (Syllabus-et);</li> <li>f) profilin e programit;</li> <li>g) diplomën dhe suplementin</li> </ul> <p>VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar, Pika 2.4/a “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, përcakton se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;</li> <li>ii. studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;</li> <li>iii. përgatitje për provime;</li> </ul>

- iv. përgatitje e tezës së diplomës;
- v. veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private;

Në dokumentin “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës” (2021), Neni 21 “Programet e studimit”, pika 1 dhe 2, shprehen se:

1. Fakulteti i Muzikës ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH.
2. Programet e studimit të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.

Neni 26 i kësaj rregullore, pika 1, shprehet se:

1. Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë”

(Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).

Sipas dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 5 i tij “Veprimtaritë formuese të programit të studimit”, përcakton se:

1. Në programin e studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi, veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet mësimit në auditor (lëndëve speciale artistike, leksione, seminare, ushtrime), studimit individual (studim, punë relacionesh, detyrash apo projektesh artistike dhe shkencore, përgatitje provimesh, përgatitje e koncertit dhe tezës së diplomës), praktikave profesionale, etj..
2. Në programin e studimit MP në Kitarë dhe Muzikë, veprimtaritë formuese grupohen mbi bazën e objektivave në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar.
3. Shpërndarja e krediteve sipas aktiviteteve formuese Brenda një discipline përcaktohet nga Departamenti Interpretimit, në funksion të natyrës së saj dhe është e shprehur në planin mësimor të këtij programi.

Neni 6 i Rregullores “Për organizimin e programit të studimit” përcakton se: Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi mbështetet në dokumentacionin themelor të tij që janë:

- a) Plani mësimor
- b) Programet mësimore të disiplinave përbërëse

c) Rregullorja mësimore e programit të studimit  
Neni 7 i Rregullores përshkruan se: Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi përmban një strukturë mësimore të grupuar si më poshtë:

- a) Lëndë bazë
- b) Lëndë karakterizuese
- c) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese
- d) Lëndë plotësuese

(Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).

Referuar dokumentit “Plani Mësimor (2021-2022)” të programit të studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi, konstatohet se lëndët/modulet janë grupuar në kategori si më poshtë:

- LËNDË BAZË - *përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (24 ECTS)*
- LËNDË KARAKTERIZUESE - *përgatitje për disiplinën shkencore - artistike (50 ECTS)*
- LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - *nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (9 ECTS)*
- LËNDË ME ZGJEDHJE (4 ECTS)
- LËNDË PLOTËSUESE - *praktika profesionale (11 ECTS)*
- DETYRIME PËRMBYLLËSE (22 ECTS)

(Dokumenti 3/03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).

Të dhënat e paraqitura në Planin Mësimor (2021-2022), janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018 (i ndryshuar), për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të ciklit të dytë Master Profesional, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018, (% e krediteve)	Të dhënat në Planin Mësimor “MP në Kitarë dhe Mësuesi”	
			ETCS	%
A	Lëndë Bazë	5%-10%	24	20%
B	Lëndë karakterizuese	30%-40%	50	41.7%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	20%-30%	13	10.8%
D	Lëndë plotësuese	10%	11	9.2%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-20%	22	18.3%
			120	100%

	<p>Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në dokumentin “Planin Mësimor 2021-2022”, me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, i ndryshuar Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë Master Profesional, nxjerr në pah se disa kategori të programit nuk përqasen, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjenden <b>gati dy herë më shumë</b> lëndë mësimore të kategorisë A (lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 20 % të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;</li> <li>- Gjithashtu, gjenden <b>gati dy herë më pak</b> lëndë mësimore të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore/integruese) në Planin Mësimor të shprehura në 10.8 % të krediteve, në raport me 20% - 30% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;</li> <li>- Kategoria B (lëndë karakterizuese) <i>ka tejkaluar me 1.7% kredite më tepër se përcaktimet e VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;</i></li> <li>- Kategoria D (lëndë plotësuese) <i>ka 0.8% kredite më pak se përcaktimet e VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;</i></li> </ul> <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u>, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës mësimore përkatëse e shprehur në kredite për kategoritë A, B, C, D, në mënyrë të veçantë kategoritë A dhe C, me qëllim që të përqasen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 2, deklarohet se “Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, nëpërmjet veprimtarive formuese, teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor/artistik/kulturor shqiptar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kitaristë të kualifikuar për të performuar në të gjitha gjinitë e muzikës si solistë, pjestarë të asambleve, si dhe pjestarë të grupeve të ndryshme dhe band-eve të muzikës moderne;</li> <li>- Mësues/instrukturë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar;</li> <li>- Pedagogë për lëndët Kitarë, Muzikë Dhome, Dëshifrazhë dhe pranë FM të UART.</li> <li>- Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore.</li> </ul> <p>Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. Plani mësimor i këtij programi studimi zhvillohet në vazhdimësi të programit të ciklit të parë Bachelor në Kitarë Klasike, dhe në aspektin përmbajtësor, është strukturuar në mënyrë të tillë që të krijojë mundësinë lidhjes logjike mes lëndëve përbërëse” (Dokumenti 25/1.1.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin e marrë në vlerësim, janë përshkruar në Nenin 8 të kësaj Rregullore, ku deklarohet</p>



	<p>se “Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi pajis studentin me njohuri të thelluara mbi teknikat e interpretimit në instrument. Përpos lëndëve që mbështesin formimin teorik dhe praktik të studentit, lënda kryesore e këtij programi Kitarë Klasike, orienton studentët drejt teknikave bashkëkohore të interpretimit duke vlerësuar individualitetin e tyre. Nisur nga vetë specifika e programit të studimit, aftësi dhe kompetencat e zhvilluara janë individuale për çdo student në varësi të estetikës personale dhe prirjeve të vetë studentit. Studentët e programit MP në Kitarë dhe Mësuesi zhvillojnë kapacitetet e tyre krijuesenë lëndën special Kitarë, duke u aftësuar në interpretimin e veprave të formave dhe gjinive të ndryshme muzikore sikurse dhe duke shfrytëzuar teknologjinë në dispozicion të krijimtarisë muzikore. Për më tepër, nëpërmjet lëndëve specifike, studentët aftësohen edhe si mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi, nëpërmjet qasjes praktike, u krijon studentëve njohuritë e nevojshme për të shërbyer në nivele të ndryshme pranë institucioneve të kulturës dhe artit.” (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Lidhur me kriterin 2, në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet se programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi ka deklaruar qartë në dokumentet e tij rregullatore se synon formimin e shprehive të veçanta në një larmi profesioneve e specialitetesh që ndërthurin përdorimin e instrumentit muzikor (kitare klasike) dhe mësimdhënien e gjinive muzikore të ndryshme në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Gjithashtu, programi jep njohuri të përparuara në fushën e studimit të instrumentit muzikor (kitarës klasike) dhe nëpërmjet lidhjes së teorisë me praktikën, përgatit studentin për punësim në institucione të kulturës, artit dhe arsimit, zhvillon të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në fushën përkatëse akademike dhe profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e specializuar të studimit dhe atë profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar dokumentit “Plani Mësimor (2021-2022)”, konstatohet se Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse, si më poshtë:</p> <p>Praktika profesionale përfshin praktikën mësimdhënëse (6 kredite) dhe praktikën artistike (5 kredite). Në total, 11 kredite, ose 9.2% nga 10% të përcaktuara në VKM Nr. 41/2018 për këtë kategori.</p> <p>Praktika profesionale përfshihet në kategorinë D (lëndë plotësuese) dhe rezultojnë të ketë 0.8% kredite më pak se përcaktimet e VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori.</p> <p>Detyrimeve përmbyllëse (diplomës) i janë akorduar 22 kredite ose 18.3% e krediteve dhe rezultojnë se përfaqësojnë me përcaktimet e VKM-së Nr. 41/2018, për këtë kategori (10%-20%).</p>

	<i>GVJ sugjeron që institucioni të rrisë deri në 10% kreditet e praktikës profesionale, për të siguruar përputhje të plotë me përcaktimet e VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Referuar dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 2, përshkruhet se “...Plani mësimor i këtij programi studimi zhvillohet në vazhdimësi të programit të ciklit të të pare Bachelor në Kitarë Klasike, dhe në aspektin përmbajtësor, është strukturuar në mënyrë të tillë që të krijojë mundësinë e lidhjes logjike mes lëndëve përbërëse” (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf). Sipas RVB (2022) programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” është program i thelluar i studimeve universitare të formimit artistik të cilat, ofrojnë studime edhe në fushën e mësuesisë, duke i aftësuar dhe formuar studentët Kitaristë edhe me kapacitete e shprehi të punës në mësimdhënie, në sektorin e arsimit të mesëm të ulët ose të lartë. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).
<b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Referuar dokumentit “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës” (2021), Neni 26, pika 1 dhe 4, shprehet se: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë, në...Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi.</li> <li>- Programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” u ofrojnë të diplomuarve me një diplomë universitare së paku “Bachelor”, arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Këto programe realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është 2 vite akademike, në përfundim lëshohet diplomë Master Profesional.”</li> </ul> (Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf). Shqyrtimi i dokumentit “Plani mësimor 2021-2022” i programit të studimit të marrë në vlerësim, tregoi se programi realizohet me 120 ECTS, ku 30 ECTS ose 25% e tyre, përfshijnë lëndë të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik, të tilla si: <b>(Kategoria A) LËNDË BAZË</b> - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodologji e mësimdhënies 6 ECTS</li> <li>- Teoritë e të nxëniet dhe menaxhim klase 6 ECTS</li> <li>- Psikologji e zhvillimit të moshave 4 ECTS</li> <li>- Vlerësimi në arsim 4 ECTS</li> <li>- Zhvillimi i kurrikulës 4 ECTS</li> </ul> Kategoria A = 24 ECTS (në total) <b>(Kategoria D) LËNDË PLOTËSUESE</b> - praktika profesionale:

	<p>- <i>Praktikë e mësimdhënie 6 ECTS</i> (Dokumenti 3/03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).</p> <p>Referuar RVB (2022), në vijim të kriterit 5, argumentohet se Universiteti i Arteve është institucion i vetëm i arsimit të lartë publik, i cili ofron programe studime Master Profesional për një disiplinë Artistike dhe Mësuesi. Si i tillë, nuk mund të aplikohet kërkesa e dytë e këtij kriteri për sigurimin e ngjashmërisë në 80% të kurrikulës së ofruar në programet “Master”, (të cilët formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë), pasi nuk ekziston një program tjetër i ngjashëm studimi. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar dokumentin “Statuti i UA (2021)”, Neni 82, pika 1 dhe 3 e tij, deklorohet se “(1) Në përputhje me parashikimet ligjore, forma e studimeve që ofrohen nga njësitë kryesore të Universitetit të Arteve është me kohë të plotë...(3) Mësimi në UART ofrohet në gjuhën shqipe”. (Dokumenti 21/I.1.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF; fq. 51).</p> <p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 1, përcaktohet se “Programi i studimeve Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, pranë Departamentit të Interpretimit (DI), Fakulteti i Muzikës (FM), në Universitetin e Arteve (UART)”. Në Nenin 11 të kësaj Rregullore “Pranimi i studentëve”, parashikohet se “Në UART, pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master Profesional” bëhet me konkurs”. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf; fq. 4, 8).</p> <p>Në dokumentin “Rregullore për zhvillimin e konkursit të pranimit në programet e ciklit të dytë Master në Fakultetin e Muzikës, UA (2022-2023)”, janë parashikuar kushtet dhe procedurat e konkurimit. (Dokumenti 63/II.1.6.4 Rregulloret dhe kriteret MASTER 2022-2023 FM.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), mësohet se “Financimi i Programit të Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” në Universitetin e Arteve, si institucion i arsimit të lartë me status të veçantë, realizohet sipas përcaktimit të Departamentit të Interpretimit për tarifat e studimeve vjetore si dhe merr parasysh, përveç Statutit të tij, Neni 92/7, edhe VKM 780 datë 26.12.2018 “Për përcakimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL”. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf; Dokumenti 64/II.1.6.5 VKM-780-Ulje-tarifa-Cikli-i-Dyte-min.pdf).</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet vetëm në Departamentin e Interpretimit, të Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, i cili gëzon Status të veçantë me VKM–së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH”. (Dokumenti VKM–së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH).</p> <p>Në RVB (2022), deklarohet se “Nuk ka një program studimi të ciklit të dytë Master, me të njëjtën emërtesë dhe njëkohësisht nga e njëjta fushë studimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf), për të krahasuar ngjashmërinë në përmbajtje sipas përcaktimit në këtë kriter, së paku 70 për qind.</p>						
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Refruar RVB (2022), mësohet se programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” zotëron kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MAS me anë të VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”. <a href="http://qzb.gov.al/eli/vendim/2022/05/11/310">http://qzb.gov.al/eli/vendim/2022/05/11/310</a> si dhe Standarteve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit: Fields of Education and Training 2013</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fusha e studimit – ARTE dhe Shkencave Humane (kodi 02)</li> <li>- Fusha e përgjithshme - ARTE (kodi 021)</li> <li>- Fusha specifike – MUZIKË DHE ARTE PERFORMUESE (kodi 0215)</li> <li>- Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” – Kode M4KIT1101; M4KIT1201; M4KIT1399</li> </ul> <p>(Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p>						
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” nuk bën pjesë në programet e përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, në tërësinë e dokumentacioneve që e shoqërojnë, dëshmon se kryesisht është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. GVJ konstaton nevojën për të rishikuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore përkatëse të shprehur në kredite për kategoritë A, B, C, D, me qëllim që të përqasen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar).</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="593 1863 794 1944">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="794 1863 976 1944">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="976 1863 1193 1944">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="593 1944 794 1989"></td> <td data-bbox="794 1944 976 1989" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="976 1944 1193 1989"></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X	
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
	X						

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Bazuar në DVV (e-ASCAL) dhe dokumentacionin e siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se Fakulteti i Muzikës si njësi kryesore, dhe Departamenti Interpretimit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike.

Fakulteti i Muzikës, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". FM ka në përbërje të tij, 3 njësi bazë:

1. Departamenti Interpretimit
2. Departamenti Kanto
3. Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP)

Referuar të dhënave në tabelën përkatëse për Personelin Akademik me kohë të plotë, viti akademik 2021-2022 (Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategoria: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë), mësohet se FM ka gjithsej **152 personel akademik**, nga të cilët **84 Personel Akademik Efektiv (PAE)** dhe **68 Personel Akademik me Kontratë (PAK)**, me nivel kualifikimi si në tabelën më poshtë:

<b>Viti akademik 2021-2022</b>		
<b>Fakulteti i Muzikës</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>
Prof. /Prof. Dr.	17	7
Prof. As. Dr.	17	1
Dr. / Doc.	13	6
MSc.	37	54
<b>Gjithësej</b>	<b>84</b>	<b>68</b>
<b>Totali</b>	<b>152</b>	

Njësia bazë, Departamenti Interpretimit, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional për Kitarë dhe Mësuesi, përmbush detyrimet për numrin minimal të përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe shkallën e kualifikimit të stafit akademik, si në tabelën më poshtë:

Viti akademik 2021-2022		
Departamenti Interpretimit	PAE	PAK
Prof. /Prof. Dr.	11	1
Prof. As. Dr.	12	1
Dr. / Doc.	10	-
MSc.	17	35
<b>Gjithësej</b>	<b>50</b>	<b>37</b>
<b>Totali</b>	<b>87</b>	

Referenca: Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategoria: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë.

Për sa më sipër njësia kryesore (FM) dhe njësia bazë (DI) përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme;
- organizimin dhe strukturën akademike;

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Kreu XII “Praktika profesionale”, Neni 28, pika 1, 3 dhe 4, shprehet se: (1) Në UA zhvillohen praktika mësimore të parashikuara si pjesë e planeve mësimore në mbështetje të formimit të profesioneve të rregulluara të mësuesisë sipas syllabuseve dhe formës së diplomës të miratuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. (3) Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti Interpretimit. (4) Personeli akademik që e drejton atë, mban lidhje me Institucionin ku ajo kryhet për secilin student. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

FM/DI përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se për çdo student të programit të studimit cakton një person në rolin e Këshilltarit Akademik. Në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 41 “Këshilltari akademik i studentëve”, përshkruhet se “Çdo student në UART ka të drejtën për të pasur një këshillues akademik. Në programin e studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi, pedagogu i Kitarës (speciale) është njëherazi edhe këshilltari akademik i studentit. Ai ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë kohës së qëndrimit në UART dhe bashkëpunon me këshillat e studentëve. Detyrat kryesore të Këshilluesit Akademik janë përcaktuar në mënyrë të detajuar në dokument.

Ndërsa për të ndjekur ecurinë dhe zhvillimin e praktikave mësimore (profesionale), Departamenti Interpretimit cakton një pedagog koordinatror i cili luan rolin e Mentorit Mbikqyrës të praktikës mësimore në institucionin pritës, ndërsa Institucioni pritës cakton një Udhëheqës të

	Praktikës mësimore. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).		
	Në dokumentin “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Departamentit të Interpretimit (2022)”, Neni 28 “Praktikat profesionale dhe mësimore”, pika 3, shprehet se “Për mbikqyrjen e zhvillimit të praktikës mësimore (profesionale), përgjegjësi i departamentit cakton pedagogun që do të ndjekë, vlerësojë dhe plotësojë dokumentacionin e praktikës mësimore. Drejtimi i praktikave nga pedagogu përkatës nuk përfshihet në ngarkesën mësimore në auditor dhe vlerësohet në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, pika II.12, gërma (e)”. (Dokumenti 88/VSA_45 Rregullore e Departamentit Interpretim FM.pdf)		
<b>Konkluzione</b>	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit përgjegjës për Programin e Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” dëshmon se disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë, të shtjelluara në mënyrë të hollësishme në dokumente rregullatore të përgjithëshme dhe të posaçme, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021) (Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</li> <li>- Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Departamentit të Interpretimit (2022). (Dokumenti 88/VSA_45 Rregullore e Departamentit Interpretim FM.pdf)</li> <li>- <i>Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në UA</i> (2021) (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</li> <li>- <i>Rregullore mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”</i> (2022). (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i	Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet për ndarjen e lëndëve në vite e semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në

<p>nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore, dhe komponentët tjerë informues. Plani Mësimor i programit të studimit, përmban 15-16 lëndë / module, duke përfshirë 1 ose 2 lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale dhe diplomimin. Komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet në total me 120 kredite. (Dokumenti 19/I.I.1.1.15 Plan mesimor master profesional kitare-21-22.pdf: 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).</p> <p><i>GVJ vëren</i> se ndarja e lëndëve me zgjedhje ka nevojë të shoqërohet me informacion shtesë/shënim sqarues në fund të planit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, gjendet një gabim teknik në planin mësimor në adresë të lëndës “Instrument” me shtrirje në dy vite akademike, me 38 kredite / 950 orë mësimore të total, nga të cilat 90 realizohen në auditor dhe sipas llogaritjes, 860 orë realizohen jashtë auditorit. Në planin mësimor është shënuar gabimisht 810 orë.</p> <p><i>GVJ sugjeron</i> që të rishikohet plani nga pikëpamja e qartësisë të informacionit që përmban dhe të korrektohet gabimi teknik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, pika 2.1 “Kreditet sipas ECTS-së”, gjerat (e) dhe (ë), lidhur me kriterin 3, shprehen si më poshtë:</p> <p>e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.</p> <p>ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Këto përcaktime gjejnë pasqyrim në dokumentet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021)”, Neni 27, “Pranimi në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë”, Neni 30, “Transferimet”, Neni 31 “Kriteret e procesit të transferimit të studimeve”. (Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në UA (2021) Neni 10, “Pranimi i studentëve në programet e ciklit të dytë”, Kreu VI “Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve”, Neni 24, 25. (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</i></li> <li>- <i>Rregullore mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 11 “Pranimi i studentëve”, Kreu VI “Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve”, Neni 24 (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</i></li> </ul> <p>Në këto dokumente rregullatore përcaktohen të gjitha modalitetet, rregullat, procedurat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit. Këtu studenti mund të informohet për të gjitha të drejtat dhe detyrime e tij, si edhe për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Në dokumentin “<i>Rregullore mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022)</i>”, Neni 40, “Informimi i studentëve”, përcaktohet se “<i>Në UA ka një sistem të organizuar informimi për të transmetuar tek studentët të gjithë informacion e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme, etj. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) <i>Format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, etj. , të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve;</i></li> <li>b) <i>Në format elektronik në faqen zyrtare të UART I cili është I aksesueshëm nga të gjithë studentët;</i></li> <li>c) <i>Të shpallura në mjediset e FM.</i></li> </ul> <p>(Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Sylabuse Kitarë dhe Mësuesi</i>” për programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të marrë në vlerësim, vërehet se të gjitha syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/ specifike të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e orëve të leksioneve dhe seminareve apo orët e laboratorit për secilën lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale, formën e kontrollit të dijes, bibliografinë e detyruar dhe atë të</p>

	<p>rekomanduar, etj. (Dokumenti 59/II.1.1.8 SYLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), formati i programit të lëndës që përdoret për hartimin e <i>syllabus</i>-eve në programin e studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi, është miratuar në nivel institucioni dhe përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivat e lëndës,</li> <li>- Temat për secilën javë,</li> <li>- Format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve,</li> <li>- Mënyrën e organizimit të mësimdhënies,</li> <li>- Lidhjen e lëndës me programin e studimit,</li> <li>- Raportin në përqindje për format e vlerësimit,</li> <li>- Semestrin ku zhvillohet lënda,</li> <li>- Frekuentimin e lëndës,</li> <li>- Literaturën bazë</li> <li>- Literaturën plotësuese</li> </ul> <p>(Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf)</p> <p>Për sa më sipër, mund të vlerësohet se syllabuset përmbajnë elementet e përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, shtojca nr. 2 “Programi i lëndës”, pavarësisht se formati i shumicës së tyre nuk ndjek të njejtën linjë me formatin e përcaktuar në VKM nr.41/2018.</p> <p>Megjithatë, gjendet ndonjë rast që syllabusi është në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (fq.10-22). (Dokumenti 59/II.1.1.8 SYLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf).</p> <p><i>GVJ sugjeron</i> që mund të rishikohet formati i syllabuseve në programin e studimit, për të siguruar përputhje me përcaktimet e VKM Nr.41/2018 (i ndryshuar).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Në dokumentin RVB (2022), institucioni deklaron se “Në tre vitet e fundit akademike programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” nuk ka pësuar ndryshime. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf). Në rast të identifikimit të nevojës për ndryshime/përmirësime/përditësime të programit studimor, atëherë institucioni do të ndiqte procedurat e përcaktuara në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Kreu IX “Vlerësimi i cilësisë”,</p> <p>Neni 38, “Rishikimi periodik i programit të studimit”, i cili shprehet se:</p> <p>(1) Fakulteti i Muzikës në bashkërendim me strukturat përkatëse të UART, nëse është e nevojshme, për ndryshime mbi 15% të programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit me grupin që është përgjegjës për këtë proces. Grupi i rishikimit përcaktohet nga përgjegjësi i njësisë bazë DI.</p>

	<p>(2) Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Dekani i fakultetit së bashku me strukturat përkatëse në UART, organizojnë procesin e tërheqjes së opinionëve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha disiplinat. Procedura se si organizohet ky proces përcaktohet nga Rektori</p> <p>Neni 39, "Regjistrimi, ruajtja e të dhënave, raportimi", përcakton se (1) Të gjitha të dhënat e grumbulluara ruhen në një dosje të veçantë të programit të studimit në arkivin e fakultetit. Kjo dosje i vihet në dispozicion grupit të rishikimit në momentin e realizimit të rishikimit të programit të studimit. (3) Raporti i rishikimit të programit të studimit analizohet nga Senati Akademik i cili e miraton atë. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi është kryesisht i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. <u>CVJ sugjeron</u> që të rishikohet plani nga pikëpamja e qartësisht të informacionit lidhur me lëndët me zgjedhje, si dhe të korrektohet ndonjë gabim i mundshëm teknik.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi i studimit i marrë në vlerësim është riorganizuar në vitin 2019, me Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019 "Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve". Gjatë këtij procesi, emërtimi i programit ndryshoi nga Master Profesional në Kitarë (90 kredite) (Dokumenti 61/II.1.5.3 urdhri Nr.397, date 10.08.2011.pdf) në Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi (120 kredite) (Dokumenti 1/Urdhër Nr.512, datë 2019-10-24 "Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve").</p> <p>Sipas Dekanit të FM, gjatë vizitës në institucion, argumentohet se qëllimi i riorganizimit ishte që ky program studimit të krijonte mundësi për thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve jo vetëm në fushën e muzikës/instrumentit të kitarës, por edhe në fushën e mësuesisë. Nga kjo perspektive, të diplomuarit në këtë program studimi do të kenë një diversitet mundësish për të vijuar studimet, si: Master i Shkencave në fushën e Muzikës dhe/ose Master i Shkencave në fushën e Edukimit, si</p>

dhe mundësi të gjëra punësimi në sektorë ku kërkohen interpretë muzikorë me kitarë apo punësim në sektorë të edukimit, si shkolla, qendra kulturore për fëmijët, etj.. Riorganizimi i programit të studimit u shoqërua me ndryshime jo vetëm në emërtim, por edhe në përmbajtjen e veprimtarive mësimore të programit, në shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave.

Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 1, shprehet se “... Programi i ciklit të dytë të studimeve (Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi), është riorganizuar për t’ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndët e muzikës pranë institucioneve arsimore të të gjitha cikleve. Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me nivelin 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.” Neni 7 i këtij dokumenti, specifikon se “... Përmbajtja e programit të studimit vjen si vazhdimësi logjike e programit të ciklit të parë në Kitarë dhe synon thellimin e njohurive të studentit dhe zhvillimin e personalitetit krijues artistik. Njëherazi programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi ka pasuruar përmbajtjen me lëndë që rrisin aftësitë pedagogjike të studentit. Nëpërmjet këtyre lëndëve, studentët thellojnë formimin e tyre si mësimdhënës në fushën e muzikës”. Neni 8, përkufizon se “Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi pajis studentin me njohuri të thelluara mbi teknikat e interpretimit me instrument... Për më tepër, nëpërmjet lëndëve specifike, studentët aftësohen edhe si mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. ... Programi i studimi nëpërmjet qasjes praktike, ju krijon studentëve njohuritë e nevojshme për të shërbyer në nivele të ndryshme pranë institucioneve të artit dhe kulturës”. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).

Referuar RVB (2022) mësohet se në harkun kohor 2019-2021, të diplomuarit në programin e studimit të marrë në vlerësim, janë punësuar në masën 100%, në sektorët publik dhe jopublik, si më poshtë:

- Në Qendrën Performancë – 3 (specialiteti kitarë)
- Në Qendrën Harmony – 1 (specialiteti kitarë)
- Në Qendrën Lincoln – 1 (specialiteti kitarë)
- Në Shkollën Kongresi i Lushnjës Lushnjë – 1 (mësues i jashtëm kitarë).

(Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).

Për sa më sipër, dëshmohet se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për punësimin e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut në fushën e interpretimit muzikor dhe mësimdhënies në lëndën e muzikës.

**Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

Referuar Planit Mësimor (2021-2022), vërehet se programi i studimit është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Lidhur me shpërndarjen e lëndëve/moduleve sipas kategorive nga A në E, për çdo vit akademik të Planit Mësimor, vërehet se:

- Në vitin e I-rë akademik zhvillohen 12 lëndë/60 kredite:
  - 2 lëndë të kategorisë A (lëndë bazë/ 12 kredite);
  - 3 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/33 kredite);
  - 5 lëndë e kategorisë C (lëndë me zgjedhje/ 10 kredite);
  - 2 lëndë e kategorisë D (lëndë plotësuese/praktikë 5 kredite);
- Në vitin e II-të akademik zhvillohen 10-11 lëndë/60 kredite:
  - 3 lëndë e kategorisë A (lëndë bazë/ 12 kredite);
  - 2 lëndë e kategorisë B (lëndë karakterizuese/ 17 kredite);
  - 2-3 lëndë e kategorisë C (lëndë me zgjedhje/3 kredite);
  - 2 lëndë e kategorisë D (praktika 6 kredite);
  - 1 lëndë e kategorisë E (diploma/ 22 kredite);

Praktika mësimdhënëse dhe praktika artistike (kategoria D/11 kredite/275 orë) kanë shtrirje vjetore.

Praktika mësimdhënëse (6 kredite/150 orë) realizohet e përqëndruar vetëm në tre javë për çdo vit akademik. Në planin mësimor orët e praktikës mësimdhënëse janë shënuar gabimisht në kolonën “orë pune individuale”, ndërkohë që duhen llogaritur në kolonën “orë mësimore në auditor”.

Praktika artistike (5 kredite/125 orë) fillon semestrin e dytë të vitit të parë dhe realizohet me 1 orë në javë. Ajo vijon në semestrin e tretë dhe të katërt me nga 1 orë në javë. Një semester ka 15 javë mësimore. Praktika artistike realizohet me 45 orë mësimore në auditor dhe 80 orë pune individuale.

Diploma (kategoria D/22 kredite/550 orë) realizohet në semestrin e dytë të vitit të dytë, me 2 orë mësimore në javë / 30 orë në auditor dhe 520 orë punë individuale e studentit. (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).

Sipas dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”, Neni 29, pika 6, specifikohet se “Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një programi artistik (vepra muzikore) dhe të një studimi mbi programin artistic. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore projektuese artistike, të tregojë aftësitë e tij profesionale – artistike dhe kompetencën pr të kryer studime, projekttime dhe realizime artistike në fushën përkatëse”. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).

	<p>Për sa më lartë, GVJ vlerëson se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Megjithatë, <i>GVJ sjell në vëmendje të institucionit</i> nevojën për të rishikuar disa aspekte teknike lidhur me të dhënat/elementet informuese që duhet të pasqyrohen në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim.</p> <p>Analiza e të dhënave të Planit Mësimor tregoi se <u>nuk është pasqyruar</u> shumica e orëve mësimore/javore për çdo semester dhe shumica e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Ndërsa, lënda "Instrument"/ 38 kredite (kategoria B) rezultojnë <u>llogaritur gabim</u> me një sasi prej 810 orë mësimore jashtë auditorit, në vend të 860 orëve të kërkuara.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se programi i studimit realizohet me 962 orë mësimore në auditor dhe 2038 orë mësimore jashtë auditorit. Sipas këtyre të dhënave, një student zhvillon mesatarisht rreth 16 orë/në javë në auditor dhe gati 34 orë /në javë jashtë auditorit, ose 3.2 orë mësimore në ditë në auditor dhe 6.8 orë mësimore jashtë auditorit. (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).</p> <p>Kjo situatë, pavarësisht specifikës së programit të studimit të marrë në vlerësim, <i>mund të perceptohet si një mbingarsë për studentin me punë individuale</i> jashtë auditorit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Referuar dokumentit "<i>Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi (2022)"</i>", Nenit 7 përshkruhet se "<i>Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi përmban një strukturë mësimore të grupuar në module si më poshtë: a) lëndë bazë; b) lëndë karakterizuese; c) lëndë ndërdisiplinore/integruese; d) lëndë plotësuese. Pjesa më e madhe e lëndëve karakterizuese janë parashikuar të shoqërohen me praktika (ushtrime) intensive mësimore në mënyrë që studenti të parapregatitet edhe praktikisht për ushtrimin e profesionit...</i>" Sipas Nenit 13 të këtij dokumenti, rres të tjerash specifikohet se "... Në programin e studimit ... aplikohen format e mësimdhënies, si: mësimdhënie individuale artistike, leksione, seminare, ushtrime (individuale dhe në grup) praktikat profesionale, praktika mësimore, konsultimet". (Dokumenti 25/1.1.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor (2021-2022), konstatohet se disa lëndë mësimore realizohen me një shtrirje kohore semestrale dhe disa të tjera janë gjithë vjetore ose edhe më shumë. Një semester ka 15 javë mësimore.</p> <p>Çdo lëndë mësimore e parashikuar për t'u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimore si: leksione (L), seminare (S), ushtrime (U).</p>

Në Planin Mësimor vërehen edhe forma të tjera specifike të mësimdhënies të miratuara nga institucioni, si: Sp/LIA ose U/MAG, të cilat janë shprehur me shkurtime përkatëse, por nuk janë shoqëruar me një legjendë/shënime shpjeguese, të tilla si:

- *Leksione / Seminare - L/S*
- *Leksione Speciale Individuale (Kitarë) - Sp/LIA*
- *Mësim Ansambël në Grup – MAG*
- *Ushtrime – U*
- *Praktikë mësimdhënie – PM*
- *Praktikë artistike – PPA*

(Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf; Standardi III.1/Kriteri 1).

Gjithashtu, *Plani Mësimor* nuk informon sa orë mësimore për një lëndë/modul janë parashikuar të jenë leksione ose seminare ose ushtrime praktike, apo forma të tjera mësimore. Kjo e bën të vështirë përcaktimin e raportit teori /praktikë dhe ushtrime.

Përsa i përket komponentit të praktikës (11 kredite/275 orë) vërehen dy tipe të praktikës, si: praktika mësimdhënëse (6 kredite/150 orë) dhe praktika artistike (5 kredite/125 orë). Praktika mësimdhënëse ka shtrirje vjetore dhe realizohet në shkolla të ndryshme, e përqëndruar vetëm në tre javë për çdo vit akademik. Praktika artistike fillon semestrin e dytë të vitit të parë, me 1 orë në javë dhe vijon në semestrin e tretë dhe të katërt me 1 orë në javë (gjithësej 45 orë në auditor dhe 80 orë punë individuale). (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).

Raporti teori – praktikë në programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi rezulton në favor të teorisë, i shprehur me 89.2 % kredite teori dhe 10.8 % kredite praktikë.

Një analizë më e hollësishme në përmbajtjen e Planit Mësimor tregon se gjenden 6-8 lëndë të veçanta të cilat përfshijnë si formë të mësimdhënies së tyre edhe ushtrimet (U). Pavarësisht se numri i orëve mësimore dedikuar ushtrimeve nuk është pasqyruar në Planin Mësimor, prezenca e ushtrimeve (U) në realizimin e këtyre lëndëve është tregues i lidhjes së teorisë me praktikën, duke kontribuar njëherazi edhe në përmirësimin e raportit teori – praktikë. (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf).

Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, në takimin e GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të marrë në vlerësim, u shpjegua se “*Detyrat lëndore / studimore që u jepen studentëve për t’u punuar në auditor ose jashtë auditorit, si dhe teza e diplomimit synojnë që të lidhin ngushtësisht teorinë me praktikën*”.

Referuar RVB (2022) për këtë kriter, mësohet se lëndët apo raporti teori – praktikë në Universitetin e Arteve, dallon për një numër të rëndësishëm lëndësh e kreditesh të lidhura me Mësuesinë, që cilësisht synojnë

aftësimin e studentëve Kitaristë për t'u integruar në aktivitetin profesional edhe përmes fushës së pedagogjisë. Programi i studimit "Master Profesional" në Kitarë dhe Mësuesi është i ngjashëm me programe të ciklit të dytë të studimeve të institucioneve ndërkombëtare, sikurse Universiteti i Vjenës për programet e Muzikës dhe Arteve të Performuara. (Dokumentit1/05 RVB KITARË.pdf).

Për sa më lartë, programi i studimit "Master Profesional" në Kitarë dhe Mësuesi, dëshmon se është në përputhje me profilin e programit të studimit, si dhe siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.

**Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Referuar Planin Mësimor (2021-2022) (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf), vërehet se veprimtaritë formuese janë ndarë në kategori A, B, C, D, E, dhe bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 41/2018 (të ndryshuar), kreditet për secilën kategori, të shprehura në %, paraqiten si më poshtë:

Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018, (% e krediteve)	Të dhënat në Planin Mësimor "MP në Kitarë dhe Mësuesi"	
			ETCS	%
A	Lëndë Bazë	5%-10%	24	20%
B	Lëndë karakterizuese	30%-40%	50	41.7%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	20%-30%	13	10.8%
D	Lëndë plotësuese	10%	11	9.2%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-20%	22	18.3%
			120	100%

Analiza e të dhënave në tabelën e mësipërme, tregon se:

- Gjenden **gati dy herë më shumë** lëndë mësimore të kategorisë A (lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 20 % të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;
- Gjithashtu, gjenden **gati dy herë më pak** lëndë mësimore të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore/integruese) në Planin Mësimor të shprehura në 10.8 % të krediteve, në raport me 20% - 30% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;

Komponenti i praktikës përfshihet në kategorinë C (11 kredite/275 orë).

Pavarësisht se ndarja sipas veprimtarive formuese të programit të studimit të marrë në vlerësim, nuk përputhet me përcaktimet e VKM NR. 41/2018, raportet midis formimit teorik (89.2 % kredite) dhe praktik (10.8 %



	<p>kredite) mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Procedurat për transferimin e studentëve përshkruhen në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”, Kreu VI “Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Gjithashtu, UA/FM/DI dëshmon për përvoja të mira të përfshirjes së studentëve në projekte mobiliteti pranë institucioneve partnere në kuadër të programit Erasmus KA107 (Norvegji, Itali e Spanjë) dhe praktika të përcaktuara qartë në Rregulloren e programit të studimit lidhur me njohjen e krediteve të përfituara në kuadër mobiliteti. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf). Gjatë vitit 2021 – 2022 rezulton 1 student nga programi i studimit i marrë në vlerësim i cili ka përfituar nga shkëmbimet në kuadër projekti. (Dokumenti 57/I.I.3.3.3 KLevis Delibashi Internship LA.pdf).</p> <p>Programi i studimit krijon mundësi punësimi të përshkruara në Nenin 37 të dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf). Referuar RVB (2022) (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf), mësohet se në harkun kohor 2019-2021, të diplomuarit në programin e studimit të marrë në vlerësim, janë punësuar në masën 100%, në sektorët publik dhe jopublik, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në Qendrën Performancë – 3 (specialiteti kitarë)</li> <li>- Në Qendrën Harmony – 1 (specialiteti kitarë)</li> <li>- Në Qendrën Lincoln – 1 (specialiteti kitarë)</li> <li>- Në Shkollën Kongresi i Lushnjës Lushnjë – 1(mësues i jashtëm kitarë).</li> </ul> <p><i>Përsa i përket përmbushjes së kriterit 4, <u>GVJ risjellë në vëmendje</u> të institucionit, rekomandimin lidhur me rishikimin e shpërndarjes së ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, D, në mënyrë të veçantë kategoritë A dhe C, me qëllim që të përjasen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar). Procesi i rishikimit duhet të mbajë në konsideratë përmirësimin e raportit teori – praktikë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”, Neni 10, mes të tjerash përcaktohet se: (1) Programi mësimor i lëndës/syllabusi hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH”. Programi i studimit ka natyrë</p>

<p>bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>specifike dhe syllabuset e tij kanë elementë dhe përbërje të veçantë. (3) Programi i lëndëd/syllabusi është objekt rishikimi në përputhje me Planin Mësimor të miratuar. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Referuar programeve lëndore/syllabuseve (Dokumenti 59/ II.1.1.8 SYLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf), vërehet se shumica e tyre respektojnë një format të veçantë, i cili nuk përputhet plotësisht me elementet e modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, Pika 2.8 “Programi lëndor (syllabus-et)”, (i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca 3 “Programi i lëndës”). Përjashtim bën vetëm një prej programeve lëndore /syllabus. (Shiko fq. 10-22, i Dokumentit 59/II.1.1.8 SYLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf). Ndërsa, një syllabus rezulton i paplotë përse i përket elementeve të tilla si: Rezultatet e të nxënit, forma e vlerësimit, literature bazë e detyruar dhe rekomanduar, etj., të parashikuara në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (të ndryshuar).</p> <p>Lidhur me elementin e literaturës bazë të detyruar dhe të rekomanduar, janë evidentuar praktika të mira të përditësimit të saj. Gjenden syllabuse që kanë përfshirë botime të 5 viteve të fundit. (Shiko fq. 28, të Dokumentit 59/II.1.1.8 SYLABUS KITARË DHE MESUESI.pdf). Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të vijojnë përpjekjen për të përditësuar literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduar.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit dëshmon se garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”, Neni 2 “Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit”, deklarohet se: <i>Programi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme torike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve ... Neni 8, përkufizon se “Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi pajis studentin me njohuri të thelluara mbi teknikat e interpretimit me instrument... Për më tepër, nëpërmjet lëndëve specifike, studentët aftësohen edhe si mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. ... Programi i studimit...nëpërmjet qasjes praktike, ju krijon studentëve njohuritë e nevojshme për të shërbyer në nivele të ndryshme pranë institucioneve të artit dhe kulturës”. Neni 36 shprehet se:</i></p>

	<p>Në përfundim të studimeve në programin MP në Kitarë dhe Mësuesi , studentit do të jetë i aftë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretimin me cilësi dhe nivel të lartë artistik si solist, pjesëtar i ansambleve, etj.</li> <li>- Zotërimin e teknikave bashkëkohore të aplikuara në interpretim;</li> <li>- Zotërimin e aftësive analitike dhe mendimit kritik për t`u thelluar në studimin e veprave muzikore, sidomos atyre të muzikës bashkëkohore;</li> <li>- Metodologjinë e mësimdhënies së lëndëve muzikore në të gjitha nivelet e institucioneve arsimore të RSH dhe jashtë saj;</li> <li>- Përbushjen e detyrave të drejtuesit artistik, redaktorit të muzikës, konsulentit artistik, punonjësit të administrates në institucionet e kulturës, sikurse dhe detyra të tjera që lidhen me aplikimin apo administrimin e krijimtarisë dhe veprimtarive muzikore. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”, Neni 37, përshkruan se: <i>Studenti i diplomuar në programin e studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi mund të punojë si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kitarist i kualifikuar për të performuar të gjitha gjinitë e muzikës si solist, pjestar i ansambleve të ndryshme muzikore;</li> <li>- Mësues/Instruktur i kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar;</li> <li>- Pedagog për lëndët Kitarë Klasike, Muzikë Dhome, Dëshifrazh pranë FM të UART;</li> <li>- Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore.</li> </ul> <p>(Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Referuar RVB (2022) mësohet se në harkun kohor 2019-2021, të diplomuarit në programin e studimit të marrë në vlerësim, janë punësuar në masën 100%, në sektorët publik dhe jopublik, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në Qendrën Performancë – 3 (specialiteti kitarë)</li> <li>- Në Qendrën Harmony – 1 (specialiteti kitarë)</li> <li>- Në Qendrën Lincoln – 1 (specialiteti kitarë)</li> <li>- Në Shkollën Kongresi i Lushnjës Lushnjë – 1 (mësues i jashtëm kitarë).</li> </ul> <p>(Dokumenti 1/ 05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>




	<p>Megjithatë, <i>GVJ tërheq vëmendjen për të rishikuar disa aspekte teknike, të lidhura kryesisht me të dhënat informuese që duhet të pasqyrohen në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasqyrimi i shumatores për orët brenda dhe jashtë auditorit, si dhe për ngarkesën mësimore javore në çdo semester;</li> <li>- Të jepet një sqarim i shkurtër në fund të Planit Mësimor, se çfarë nëkuptojnë format e tjera specifike të mësimdhënies si, Sp/LIA ose U/MAG;</li> <li>- Të korrektohet gabimi teknik lidhur me ngarkesën mësimore jashtë auditorit për lëndën "Instrument"/ 38 kredite (kategoria B);</li> <li>- Të shënohen orët mësimore të praktikës mësimdhënëse në kolonën "orë mësimore në auditor";</li> <li>- Të përmirësohet raporti teori – praktikë.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>	

<b>Standardi II.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit të marrë në vlerësim dhe përshtatjen e tij sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, institucioni ndjek procedura të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse.</p> <p>Në dokumentin "<i>Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi (2022)"</i>", Kreu IX "<i>Vlerësimi i cilësisë</i>", Neni 38, "<i>Rishikimi periodik i programit të studimit</i>", shprehet se: (1) <i>Fakulteti në bashkëpunim me strukturat përkatëse në UART, nëse është e nevojshme, për ndryshime mbi 15% të programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit nga grupi i cili është përgjegjës për këtë proces. Grupi i rishikimit përcaktohet nga përgjegjësi i njësisë bazë/DI...</i> (2) <i>Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik...Procedura se si organizohet ky process përcaktihet nga Rektori. Neni 39 "Regjstrimi, ruajtja e të dhënave, raportimi"</i>, specifikon se: (1) <i>Të gjitha të dhënat e grumbulluara sipas Nenit 39, ruhen në një dosje të veçantë të programit në arkivin e fakultetit. Kjo dosje i vihet në dispozicion grupit të rishikimit në momentin e realizimit të rishikimit të programit të studimit. ...</i> (3) <i>Raporti i rishikimit analizohet nga Senati</i></p>

	<p><i>Akademik dhe miratohet prej tij.</i> (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Në kuadër të riorganizimit të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019), UART/FSHM dëshmon se është konsultuar me institucionet partnere, sikurse Ministria përgjegjëse për Arsimin (shiko Dokumentin 68/II.5.1.1 urdhëri 616 për ngritjen e grupit të punës.pdf). Institucioni deklaron FM/DI ka bashkëpunuar edhe me ish të diplomuarit në fushën e muzikës, si dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës si institucione publike ashtu edhe organizma joqeveritarë, të përfshirë në jetën kulturore, artistike e pedagogjike. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik tregoi për bashkëpunimin e FSHM/DI-së me institucionet partnere për praktikën, të cilat kanë qënë frytdhënëse për të diskutuar mbi çështje të lidhura me sfidat që ndeshen në tregun e punës. Këto diskutime kanë shërbyer për të analizuar dhe gjykuar mbi nismat e DI për të rishikuar, përmirësuar ose riorganizuar programet që ofron.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>FSHM/DI nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit</p> <p>Institucioni ka ngritur dhe vënë në funksion NJSBC, e cila sipas dokumentit “Rregullore e funksionimit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, 2021”, Neni 3, mes të tjerash shprehet se: <i>Qëllimi i SBC është ... (c) nxitja e studentëve për të qënë aktivë në dhënien e opinioneve mbi çështjet aktuale.</i> Neni 5, përshkruan se: <i>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) përbehet nga 1 specialist i sigurimit të cilësisë në UART, 1 përfaqësues për secilin fakultet dhe 1 student.... Anëtari i Komisionit, pjesë e studentëve të UART, duhet të jetë me mestare të përgjithshme mbi 8 (tetë).</i> Neni 6 specifikon se midis të tjerash, <i>KSBC bën vlerësime për stafin akademik ... duke filluar me pyetësorët e studentëve.</i> Neni 10, përcakton se: <i>Raporti i KSBC përfshin përshkrime, analiza, përfundime, urdhra dhe rekomandime...</i> për përmirësimin e programit të studimit. (Dokumenti 87/VSA Nr_24, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit te Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise, ne UART.pdf; Dokumenti 95/ Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.PDF).</p> <p>Nga ana tjetër, institucioni ruan kontakte të drejtëpërdrejta dhe të vazhdueshme me studentin nëpërmjet Këshilltarit Akademik. Sipas dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi (2022)”, Neni 41, përcaktohet se: <i>Çdo student në UART ka të drejtën për të pasur një Këshillues Akademik</i></p>

	<p>... Ai ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në UART dhe bashkëpunon me këshillat e studentëve. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se: <i>Këshilluesi Akademik ruan kontakte me studentin edhe pas diplomimit të tij. Shpesh ish të diplomuarit, pavaresisht se ku janë të punësuar, brenda apo jashtë vendit, vijojnë të bashkëpunojnë profesionalisht me pedagogët e tyre në kuadër të aktiviteteve të ndryshme muzikore. Kjo marrëdhënie, u jep mundësi palëve që të diskutojnë profesionalisht për kërkesat e reja në tregun e punës dhe t'i reflektojnë ato në procesin e përmirësimit programit të studimit. Shkëmbimi i përvojës së përshkruar nga stafi akademik ilustron edhe nga Dokumenti 35/I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takime etj.pdf.</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në kuadër të riorganizimit të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” FM/DI përshtatën programin e studimit nga MP në Kitarë në MP në Kitarë dhe Mësuesi (Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019), duke reflektuar në këtë mënyrë propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e muzikës dhe mësimdhënies së muzikës në sistemin parauniversitar, në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, institucione të artit dhe kulturës.</p> <p>Sipas RVB (2022) mësohet se për përmirësimin, përditësimin dhe përshtatjen e programit të studimit, DI mbështet edhe në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përvojën mësimore akademike personale të anëtarëve të personelit akademik;</li> <li>- Shkëmbimet e personelit akademik në kuadër të projekteve Erasmus+ KA 107 (15 personel akademik <i>dërguar</i> dhe 28 personel akademik <i>ardhur</i>);</li> <li>- Master - classeve të artistëve ndërkombëtarë që zhvillohen pranë FM; (Dokumenti 35/I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takime etj.pdf).</li> <li>- Takime dhe dokumenta të prodhuar nga Rrjeti Global ELIA dhe AEC, etj.</li> </ul>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë, UART/FM/DI nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës” (2021), Neni 26, pika 1 dhe 4, shprehet se: <i>Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë, në...Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi.</i> (Dokumenti 41/I.1.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 2, përcaktohet se “Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, nëpërmjet veprimtarive formuese, teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor/artistik/kulturor shqiptar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kitaristë të kualifikuar për të performuar në të gjitha gjinitë e muzikës si solistë, pjestarë të asambleve, si dhe pjestarë të grupeve të ndryshme dhe band-eve të muzikës modern;</li> <li>- Mësues/instrukturë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar;</li> <li>- Pedagogë për lëndët Kitarë, Muzikë Dhome, Dëshifrazhë dhe pranë FM të UART.</li> <li>- Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore.</li> </ul> <p>Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme torike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në Universitetin e Arteve” (2021), Neni 31, përcakton se: <i>Punimi diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti/programi artistik apo të një studimi me karakter përgjithësues në fushën e programit të studimit që ka kryer. Punimi diplomës përmban një sërë detyrash dhe kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore projektuese artistike të tregojë aftësitë e tij profesionale-artistike dhe kompetencën për të kryer studime, projekttime dhe realizime artistike në fushën përkatëse.</i> (Dokumenti 94/ Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF)</p> <p>Sipas RVB (2022) mësohet se programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofrohet me qëllim “për të krijuar, zhvilluar, përçarur dhe mbrojtur dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe të kulturës,</p>

	<p>si dhe të nxisë dhe zhvillojë kërkimin artistik/shkencor”. (Dokumentil/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi etikës të UA” (2020) Neni 5 i tij, pika 1, që shprehet se “<i>Personeli akademik gëzon liri akademike në kërkimet, punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin artistik-shkencor, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikse, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët</i>”. (Dokumentil 42/I.1.3.1.13 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore-artistike. Për përmbushjen e këtij kriteri, FSHM/DI udhëhiqet nga “Kodi i Etikës së UA (2020)”, Neni 5 i tij “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, pika 3, që përcakton se “<i>Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lire dhe të pavarur, si dhe t’u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit</i>” (Dokumentil 42/I.1.3.1.13 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</p> <p>Referuar RVB (2022) FSHM/DI deklaron se: Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” mundëson, nxit dhe motivon studentët kitaristë të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Detyrimeve semestrare dhe të përmbylljes së ciklit të studimit Master të studentëve të klasës së Kitarës,</li> <li>- Pjesëmarrjes në aktivitete artistike dhe kërkimore artistike në kuadër të departamentit të interpretimit apo dhe të Fakultetit të Muzikës. (Aktivitete kërkimore në fushën e interpretimit muzikor, për vetë specifikën e UART, janë të natyrës së kërkimit artistik),</li> <li>- Përzgjedhjes dhe angazhimit të studentëve më të dalluar edhe në projekte bashkëpunimi të sektorit të jopublik, përmes OJF në fushën e muzikës.</li> </ul> <p>(Dokumentil/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se studentët e programit të marrë në vlerësim angazhohen nga pedagogët e tyre në detyra kursi me karakter</p>



	<p>studimor me qëllim zhvillimin e aftësive për të hulumtuar dhe shqyrtuar literaturën përkatëse. Gjithashtu, studentët angazhohen në realizimin e projektit kërkimor në kuadër të punimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. FM/DI përfshin studentët në aktivitetet artistike dhe shkencore të organizuara në nivel fakulteti, në projekte mobiliteti dhe veprimtari të ndryshme studimore/artistike, me përfshirje edhe të stafit akademik.</p> <p>Në dokumentin “Analizë vjetore 2021-2022”, mes të të tjerash raportohet se “Aktiviteti artistik i pedagogëve dhe studentëve ka qënë shumë më i pasur se vitet e mëparshme, falë edhe jetës artistike dhe atmosferës së krijuar në UART me rastin e 60 vjetorit të FM... Vetëm në periudhën prill-qershor, 2022 janë organizuar dhe realizuar 60 koncerte me pjesëmarrjen e 90% të studentëve dhe thuajse të gjithë pedagogëve të DI me klasat e tyre...Disa pedagogë kanë organizuar aktivitete artistike me ansamble të mëdha dhe grupe më të vogla ku kanë përfshirë mjaftë studentë. Gjithashtu, paralelisht janë organizuar edhe master-klasë dhe workshope (free) me studentët...Këto aktivitete kanë qënë ... si laborator dhe përballje me publikun për studentët dhe pedagogët e DI. Një pjesë e pedagogëve dhe studentëve kanë marrë pjesë në aktivitete të rëndësishme jashtë vendit...Përsa i përket projekteve shkencore, vazhdon të ketë një numër të kufizuar të tyre ... (Dokumenti 44/I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf; fq. 2-3).</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në dokumentin “Statuti i UA” (2021), Neni 119 “Për financimin e kerkimit artistic/shkencor”, pika 4, specifikohet se “Në buxhetin që përcaktohet nga Administratori i UART për çdo njësi kryesore sipas planifikimit të argumentuar, duhet të përcaktohet edhe një fond që të mbështesë veprimtarinë mësimore-kërkimore-shkencore”. Neni 120, pika 1, shprehet se “UART nëpërmjet njësisë përbërëse u ofron të tretëve ose pranon oferta për kërkim artistik – shkencor, ekspertizë artistike – shkencore, shërbime të tjera ose i realizon ato në bashkëpunim me të tretë. Pika 2, përcakton se “Të ardhurat që krijohen nga ky shërbim, administrohen nga UART në favor të njësisë përkatëse që e ofron këtë shërbim në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”. (Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Në RVB (2022) deklarohet se “Për specifikën e strukturës së Universitetit të Arteve, Departamenti i Interpretimit nuk administron në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Këto të ardhura administrohen në mënyrë të centralizuar”. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” garanton orientim në fushën e studimeve përkatëse dhe kërkimit shkencor.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1832 756 1906">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="756 1832 979 1906">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="979 1832 1193 1906">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1193 1832 1434 1906">Përbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1906 756 1957"></td> <td data-bbox="756 1906 979 1957"></td> <td data-bbox="979 1906 1193 1957"></td> <td data-bbox="1193 1906 1434 1957" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo						
			X						

Standardi	I.7
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>FSHM/DI dëshmon se mbështet grupet lëndore dhe projektet artistike/shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera artistike/shkencore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Sipas RVB (2022) mësohet se DI mbështet (a) grupin lëndor “Harqe dhe Kitarë” në projektet e reja kërkimore-shkencore si kusht për vijimin e gjenerimit të natyrshëm tyre në një kontekst universitar specifik, (b) grupet lëndore dhe siguron bashkëpunimin përmes koordinimit me struktura të tjera kërkimore si Njësia Bazë KMDP për realizimin e objektivave të përbashkët në përfshirjen e të rinjve në projekte e dhe produkte artistike e kërkimore në fushën e muzikës bashkëkohore. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Analizë vjetore 2021-2022”, mes të të tjerash raportohet se “DI vazhdon të mbështesë pa kursim projektet artistike individuale/kolektive apo evente të rëndësishme të pedagogëve dhe studentëve, siç janë Festalet Ndërkombëtare...Përsa i përket projekteve shkencore, vazhdon të jetë një numër i kufizuar... (Dokumenti 44/I.1.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf; fq. 2-3).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>FSHM/DI dëshmon se angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter artistik/kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> <p>Në dokumentin “Analizë vjetore 2021-2022”, mes të të tjerash raportohet se “Programi Erasmus ka rifilluar pas një ndërprerje për shkak të pandemisë, studentët kanë shkuar përmes këtij programi në Norvegji (6 studentë) dhe Spanjë (3 studentë) ... gjithashtu ka pasur edhe shkëmbime profesorësh si, 3 në Trieste, 3 në Cosenza-Itali, 6 në Vigo, 2 në Granada, Spanjë, si dhe nje personel administrative në Vigo, Spanjë”. (Dokumenti 44/I.1.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf; fq. 2-3).</p> <p>Në e-ASCAL, janë dokumentuar një sërë marrëveshjes të realizuara në kuadër projektsh me karakter studimor, kërkimor dhe artistik që angazhojnë personelin akademik dhe studentët e FM/DI. (Shiko dokumentein 45/I.1.3.2.1 Uart agder 2021 agreement.pdf; 46/I.1.3.2.2 2022 VIGO interinstitutional-agreement_conservatorio musica vigo.pdf; 47/I.1.3.2.3 2022 GRANADA .interinstitutional-agreement_conservatorio musica granada_2022.pdf; 48/I.1.3.2.5 MoU - Konservatori i Muzikes dhe Dansit Paris.pdf; 49/I.1.3.2.6 . vigo double degree.pdf; 50/I.1.3.2.7 Lettera d'intenti UART UNIBARI.pdf; 51/I.1.3.2.8 . ROMA TOR VERGATA. pdf).</p> <p>Në RVB (2022) deklarohet se personeli akademik dhe studentët e Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi angazhohen për realizimin e</p>

	<p><i>objektivave të analizave, studimeve, projekteve me karakter kërkimor – artistik – shkencor, të porositura ose të fituara në kuadër të projekteve të financuar si nga fonde të brendshme ashtu edhe të huaja. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse dëshmon se organizon aktivitete të ndryshme artistike, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Në RVB (2022) deklarohet se për specifikën e vetë Departamentit të Interpretimit, lloji i aktiviteteve të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët Kitaristë për arritjen e objektivave lidhen me realizimin e koncerteve dhe pjesëmarrjen e tyre në festivale, konkurrime apo master-classe. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 2, përcakton se: Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike, për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës sepse, përgjatë viteve të studimeve, si dhe aktivitetit praktik profesional e artistik, studentët Kitaristë përgatiten jo vetëm në aspektin e përmbajtjes dhe formës por edhe cilësisht për të marrë pjesë në mënyrë konkurruese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>për tregun kombëtar të punës, përmes audicioneve për pozicione pranë institucioneve kulturore dhe / ose në portalin “Mësues për Shqipërinë” për pozicione në rolin e mësimeve,</i></li> <li>- <i>për tregun ndërkombëtar të punës, përmes audicioneve për pozicione në ansamble të përkohshme kitarash dhe bashkëpunime me ansamble rajonale të kitarave.</i></li> </ul> <p>(Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se gjenden mjaft nga studentët e diplomuar në UART/FM/DI të cilët janë punësuar jashtë vendit dhe performojnë me sukses në institucione artistike ndërkombëtare, si dhe disa prej tyre janë të mirënjohur dhe me famë botërore për nga kualiteti artistik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>FM/DI si pjesë e UART, dëshmon përmes dokumentit (55/I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf) se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me rrjete profesionistësh nga fusha e arsimit, si DAR/ZAV, dhe me institucione/qendra artistike, etj., me të cilat bashkëpunon për realizimin të praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore-artistike, dhe që ndihmojnë njësinë përgjegjëse të reflektojë dhe të punojë për mbarëvajtjen, përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programeve</p>

	<p>të posaçme me fushë specifike të studimit, sikurse programi MP në Kitarë dhe Mësuesi.</p> <p>Në RVB (2022) shpjegojet se “Diploma Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” është një produkt i reagimeve për një përditësim të programit të studimit, pas analizave dhe deduksioneve mbi tregun e punës në fushën e mësimdhënies në arte”. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi përputhet me aktet ligjore në vend, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 (i ndryshuar me Ligjin Nr.10357, dt. 16.12.2010, me Ligjin Nr.10470, dt. 13.10.2011 dhe Ligjin Nr.90/2015, dt. 17.07.2014) “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Nenin 8 të tij që përcakton kriteret për të diplomuarit përpara se të ushtrojnë në një profesion të rregulluar, duhet që: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në Urdhrin e Profesionit përkatës, që në rastin e mësuesit janë Drejtoritë Arsimore Rajonale. <a href="https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRRI.pdf">https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRRI.pdf</a></li> <li>- Urdhër nr.437, datë 20.07.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. <a href="https://arsimiparauniversitar.gov.al/urdher-nr-437-date-20-07-2022-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-rregulloren-per-organizimin-dhe-zhvillimin-e-praktikave-profesionale-per-profesionin-e-rregulluar-te-mesuesit/">https://arsimiparauniversitar.gov.al/urdher-nr-437-date-20-07-2022-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-rregulloren-per-organizimin-dhe-zhvillimin-e-praktikave-profesionale-per-profesionin-e-rregulluar-te-mesuesit/</a></li> </ul>		
<b>Konkluzione</b>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim, kërkim shkencor dhe artistik.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>		Përmbushet kryesisht <b>X</b>	Përmbushet plotësisht

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 13, pika 1, midis të tjerash deklarohet se: “Në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi aplikohen format e mësimdhënies si: mësimdhënie individuale artistike, leksione, seminare, ushtrime (individuale dhe në grup), praktikatat profesionale, praktikatat mësimore, konsultimet”. Pika 2 e nenit 13 specifikon se “Mënyra e vlerësimit për arritjet e studentit realizohet nëpërmjet: bashkëbisedimeve, kontrolleve teknike, mbrojtje e detyrave dhe projekteve (individuale/grup), mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, mbrojtje e temave të diplomave, aktivitete artistike, etj.”, Pika 3 përcakton se “Kontrolli i dijeve mund të bëhet nëpërmjet: a) provimit me shkrim, b) provimit me gojë, c) kombinimi i dy formave të mësipërme, d) vlerësimit të detyrave dhe projekteve, e) provimi në grup (për grupet e muzikës së dhomës dhe asambleve), f) provimi individual (për lëndët special dhe lëndët individuale artistike). Pika 4 thekson se “Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së vetë lëndës”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Siaps RVB (2022), format e miratuara nga organet përkatëse të institucionit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione / Seminare - L/S</li> <li>- Leksione Speciale Individuale (Kitarë) - Sp/LIA</li> <li>- Mësim Ansambël në Grup – MAG</li> <li>- Ushtrime – U</li> <li>- Praktikë mësimdhënie – PM</li> <li>- Praktikë artistike – PPA</li> </ul> <p>(Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Referuar programeve lëndore të programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, veçanërisht rubrikës “Mënyra e mësimdhënies” dhe “Kontrolli i njohurive”, vërehet se sipas specifikës së lëndës, janë shënuar format e mësimdhënies të tilla si: leksion, ushtrime, seminare, konsultime, punë individuale, mësim artistik në grup, praktikë, udhëheqje detyrash, etj. Ndërsa si formë të kontrollit të njohurive janë përshkruar: mbrëmje muzikore, saxho, kontroll teknik, esse, detyra, projekt, kolokium, provim, firmë, koncert, etj. (Dokumenti 4/04 SYLABUS KITARE.pdf).</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, në programin e studimit, bazohen kryesisht në leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat studimore/hulumtuese dhe praktika artistike. Mësimdhënia organizohet në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme si: diskutim, praktikë muzikore, veteksplorim, refleksione, analiza të veprave muzikore, nxitje e mendimit kritik, prezantime në PowerPoint, etj, duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën mësimore dhe ushtrimin artistik. Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në projekte studimore artistike/mobiliteti, në aktivitete artistike kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FM/DI në bashkëpunim me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit, si dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Referuar jetëshkrimit profesional të personelit akademik të DI, vërehet se secili prej tyre është i kualifikuar me grada shkencore e tituj akademikë, si dhe ka përvojë të pasur artistike dhe mësimdhënëse. (20/ I.L.I.1.16 Jeteshkrimet e PE te DI.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), personeli akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, për vetë <i>specifikën e programit, lëndëve individuale artistike ose në grupe në ansambël</i>, respekton dhe i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke zbatuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Forma tradicionale e alternative të mësimdhënies,</i></li> <li>- <i>Mënyra të personalizuar studimi e kërkimi individual në kuadër të larmisë së karakteristikave të studentëve,</i></li> <li>- <i>Metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, sipas karakteristikave psiko-motore e të ndjeshmërisë individuale artistike të çdo studenti,</i></li> </ul> <p>(Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se duke u nisur nga natyra dhe kërkesat e lëndës, stafi akademik përkatës zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies, të cilat i përgjigjen objektivave dhe natyrës specifike të lëndës, si dhe diversitetit të nevojave dhe sfidave personale të studentëve. Personeli akademik ofron metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, duke respektuar ritmin e studentëve, si dhe</p>

	demonstron se është i hapur për të përmirësuar në vazhdimësi mësimdhënien e tij.
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UART/FM/DI dëshmon përmes marreveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, se mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. (Shiko dokumentein 45/I.I.3.2.1 Uart agder 2021 agreement.pdf; 46/I.I.3.2.2 2022 VIGO interinstitutional-agreement_conservatorio musica vigo.pdf; 47/I.I.3.2.3 2022 GRANADA .interinstitutional-agreement_conservatorio musica granada_2022.pdf; 48/I.I.3.2.5 MoU - Konservatori i Muzikes dhe Dansit Paris.pdf; 49/I.I.3.2.6 . vigo double degree.pdf; 50/I.I.3.2.7 Lettera d'intenti UART UNIBARI.pdf; 51/I.I.3.2.8 . ROMA TOR VERGATA. pdf).</p> <p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se ka përfituar nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e artit dhe mësimdhënies, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e transferimit të përvojës artistike dhe teknikat e mësimdhënies në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Në dokumentin “Analizë vjetore 2021-2022”, mes të të tjerash raportohet se “Programi Erasmus+ ka rifilluar pas një ndërprerje për shkak të pandemisë, studentët kanë shkuar përmes këtij programi në Norvegji (6 studentë) dhe Spanjë (3 studentë) ... gjithashtu ka pasur edhe shkëmbime profesorësh si, 3 në Trieste, 3 në Cosenza-Itali, 6 në Vigo, 2 në Granada, Spanjë, si dhe nje personel administrative në Vigo, Spanjë”. (Dokumenti 44/I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf; fq. 2-3).</p> <p>Referuar dokumentit “Analizë vjetore 2021-2022”, mes të tjerash theksohet se “DI vazhdon të mbështesë pa kursim projektet artistike individuale kolektive, apo evente të rëndësishme të pedagogëve ...” (Dokumenti 44/I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se “UART ka një zyrë koordinimi për projektet Erasmus+ pranë rektoratit, të gjitha trajnimet në lidhje me këtë program janë zhvilluar në nivel universiteti dhe jo njësie kryesore/bazë”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student rrendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Referuar të dhënave për numrin e PA për çdo njësi bazë të FM (2021-2022) mësohet se aktualisht “Departamenti i Interpretimit (DI) i cili ka në përgjegjësi realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, ka gjithësej 87 personel akademik, ku 50 PAE, nga të cilët 11 Prof. /Prof.Dr., 12 Prof.Asoc.Dr., 10 Dr./Doc, dhe 17 Msc, si dhe 37 PAK, nga të cilët 1 Prof. /Prof.Dr., 1 Prof.Asoc.Dr., 0 Dr./Doc, dhe 35 Msc. Gjenden 33 (66%) PAE të cilët mbajnë grada e tituj shkencorë, dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre, demonstion një prodhimtari të admirueshme në fushën e veprimtarive artistike brenda dhe jashtë vendit, si botimeve shkencore. (Dokumenti 6/Tabelat-Numri i</p>

<p>ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Seksioni: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë).</p> <p>Bazuar në jetëshkrimet e personelit akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, vërehet se secili prej tyre është i mirënjohur në fushën e artit dhe kulturës, disa prej tyre edhe në arenën ndërkombëtare. (Dokumenti 20/I.I.1.1.16 Jeteshkrimet e PE te DI.pdf).</p> <p>Nga krahasimi i të dhënave në dokumente lidhur me jetëshkrimet/diplomat/titujt e PA dhe syllabuseve të lëndëve që ata zhvillojnë, vërehet një përputhje midis fushës akademike/specialitetit artistik dhe atij kërkimor të titullarit të lëndës/modulit dhe profilit të programit lëndor dhe studimor që ai zhvillon. Në të gjitha rastet, stafi akademik zotëron kompetenca dhe kualifikime në përputhje me lëndën përkatëse. (Dokumenti 20/I.I.1.1.16 Jeteshkrimet e PE te DI.pdf; Dokumenti 70/III.1.4.1. Diploma e titujve te PE te DI.pdf; Dokumenti 4/04 SYLABUS KITARE.pdf).</p> <p>UA/FM/DI respekton procedura dhe kriteret (të përgjithshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin Rregullore e UA (2021), Neni 92 i cili përcakton procedurat dhe modalitetet për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për t'i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programeve të studimit. (Dokumenti 23/I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit te Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF)</p> <p>Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive me në qendër studentin, duke nxitur aftësitë e tyre krijuese dhe kritike, si dhe autonominë dhe qëndrimet e përgjegjeshme. Studentët treguan se ata komunikojnë lirshëm me pedagogët lidhur me mevojat e tyre për të nxënë, si dhe ndiejnë çdo ditë udhëheqjen, përkrahjen, mbështetjen dhe trajtimin e tyre me respekt nga ana e pedagogëve.</p> <p>Ndërsa personeli akademik, vuri theksin në një prej praktikave të mira të DI, që mundëson studentin të zgjedhë paraprakisht pedagogun e lëndës së mësimit individual special duke përforcuar filozofinë udhëheqëse të UART dhe njërive të tij përbërëse për të vendosur studentin në qendër.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e</p>	<p>Në dokumentin “<i>Rregullore e Funkcionimit të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në UART</i>” (2021), Neni 2, mes të tjerash</p>



<p>metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>përcakton se përmes kësaj rregullore (SBC) ka për objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit artistik shkencor. Në Nenin 12, specifikohet se <i>“Pyetësorët e stafit akademik dhe studentëve janë format e përdorëshme për realizimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, por jo vetëm”</i>. (Dokumenti 87/VSA Nr_24, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funkcionimit të Njesise të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në UART.pdf).</p> <p>Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, FM dëshmon se kryen në mënyrë periodike vlerësim dhe analizë të cilësisë së mësimdhënies duke përfshirë edhe studentët. (Analizë e pyetësorit për stafin akademik Fakulteti i Muzikës (2019), Dokumenti 63/II.5.5 pyetesor.pdf Programi Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi").</p> <p>Gjithashtu, njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, kryen <i>analiza periodike</i> (pas mbrëmjeve muzikore apo provimeve vjetore), (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf), duke tërhequr mendimin e studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies, si dhe <i>analiza vjetore</i> ku merr në shqyrtim rezultatet e pyetësorëve me studentët të realizuara nga NJSBC, dhe reflekton mendimet dhe sugjerimet e tyre në procesin e përmirësimit të formave të metodave të mësimdhënies. (Dokumenti 44/ I.I.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf).</p> <p>Kjo përvojë tregon se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit, formave të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë, është pjesë e politikave dhe strategjisë së UART/FM/DI.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>UART ka ngritur në nivel institucional strukturat përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Në statutin e UA (2021), Neni 136, shprehet se <i>“Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) funksionon pranë Sektorit të Kurrikulës dhe Informimit të Studentëve, dhe është përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë në UART dhe programeve të studimit që ofron. NJSBC është përgjegjëse për koordinimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”</i>. (Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimi i GVJ me personelin në përbërje të NJSBC-së, u mësua se kjo strukturë e bazon veprimtarinë e saj në Rregulloren përkatëse (Dokumenti 23/I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF). KSBC dhe NJSBC promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me FM/DI aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Në dokumentin <i>“Kodi i etikës së UA”</i> (2020), Neni 5 <i>“Përhapja e dijeve dhe liria akademike”</i>, në pikën 1, përcaktohet se <i>“Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet artistike-shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t'i përmbahen</i></p>

	<p><i>përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë krijimin artistik-shkencor, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët". (Dokumenti 42/I.1.3.1.13 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</i></p> <p>FM/DI dëshmon se mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Shëmbull i mirë në këtë drejtim është organizimi i masterclasse-ve nga profesorë spanjollë e italianë, gjatë vitit 2022, ku personeli akademik të FM/DI ka pasur mundësi të ballafaqojë mësimdhënien e tij me atë të kolegëve homologë në Trieste, Vigo apo Granada. (Dokumenti 35/ I.1.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takime etj.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se çdo pedagog është përgjegjës për rritjen e tij profesionale, rishikimin e programeve lëndore, përditësimin e literaturës, përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, eksperimentimin me metoda të reja, cilësinë e krijimit artistik dhe shkencor, etj.</p>		
<b>Konkluzione</b>	<p>UART/FM/DI garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në FM, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në UART (2021), Neni 12, midis të tjerash përcakton format e kontrollit të dijes të studentëve që sipas pikës 10 të këtij neni, “konkretizohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilat hartohen nga sekretaria mësimore mbi bazën e propozimeve të departamenteve. Grafiku i detyrimeve shpallet deri dy javë pas fillimit të semestrit”. Neni 17 i kësaj Rregullore,</p>

	<p>përcakton mënyrat e të provuarit të dijeve. (Dokumenti 94/ Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</p> <p>Rregullore e Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi (2022) është një dokument i posaçëm i hartuar nga FM/DI, që në kreun V “<i>Kontrolli i dijeve</i>”, Neni 17, përcakton kriteret dhe mënyrën e të provuarit të dijeve dhe aftësive të studentëve, kreu VII “<i>Praktika profesionale</i>” përcakton mënyrën e organizimit dhe vlerësimit të komponentit të praktikës profesionale, dhe kreu VIII “<i>Diplomimi</i>” përshkruan modalitetet, standardet dhe rregullat e mbrojtjes së provimit të diplomës në përfundim të programit të ciklit të dytë Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi. Sipas Nenit 29, pika 1, Provimi i diplomës kryhet nëpërmejt paraqitjes së tezës së diplomës dhe mbrojtjes artistike të krijimtarisë muzikore”. (Dokumenti 2/ Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Në këtë kuadër, DI ka përgatitur edhe një Udhëzues për hartimin e diplomës/mikrotezës që orienton studentët në aspektin formal, teknik, gjuhësor, dhe në respektimin e rregullave bazë të shkrimit akademik përgjatë punimit të diplomës. (Dokumenti 5/UDHEZUES për DI.pdf, Seksioni: Vizita dyditore dhe informacin shtesë).</p> <p>Sipas RVB (2022) Universiteti i Arteve, në kuadër të transparencës dhe të komunikimit me të interesuarit pasqyron në faqen e vet internet <a href="http://uart.edu.al">uart.edu.al</a> çdo dokument lidhur me legjislacionin dhe rregulloret respektive me problematikat e jetës universitare. Informacioni është publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë studentët, përfshirë dhe ata Kitaristë. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Si pjesë e UART, personeli akademik i FN/DI zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “<i>Për përhapjen e dijeve dhe lirisë akademike</i>”, pika 4 që përcakton se “<i>Personeli akademik duhet t’i shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit, duke e realizuar këtë nëpërmjet literaturës, bashkëbisedimit, leksioneve, demonstrimit artistik profesional sipas fushës së studimit, praktikës e provimeve</i>”. (Dokumenti 42/I.I.3.1.13 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</p> <p>Rregullore e Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi (2022), Nenin 17 “<i>Mënyrat e të provuarit të dijeve</i>”, përcaktohet se (3), “<i>Modalitetet e vlerësimit të lëndës/modulit shprehen në syllabus</i>”. (Dokumenti 2/ Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, në kategorinë “<i>Forma e kontrollit të dijeve</i>”, është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe artistike të studentëve. (Dokumenti 4/04 SYLLABUS KITARE.pdf).</p> <p>Institucioni raporton në RVB (2022) se titullari i lëndës dhe / ose modulit të planit mësimor të Programit të Studimit <i>Master Profesional</i></p>

	<p>në "Kitarë dhe Mësuesi", në orën e parë të mësimit, në fillim të çdo lënde apo moduli informon studentët mbi</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve si dhe në tabelën e Planit mësimor të Programit të Studimit.</li> <li>- Veprimtaritë që do të zhvillohe në kuadër të lëndës (leksione individuale artistike, leksione në grup, seminare, ushtrime, etj).</li> <li>- Format e kontrollit (Provim apo nënshkrim).</li> <li>- Kushtet specifike për t'u pranuar në provimin përfundimtar.</li> <li>- Raportin e vlerësimeve në funksion të rezultatit përfundimtar.</li> <li>- Mënyrën e realizimit të formave të kontrollit.</li> </ul> <p>(Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas Rregullores Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 42 "Format e kontrollit", shprehet se (1) kontrolli i dijes mund të bëhet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimit me shkrim;</li> <li>- Provimit me gojë;</li> <li>- Vlerësimit të detyrave dhe të projekteve;</li> <li>- Kombinimi i tre formave të mësipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt;</li> <li>- Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special) konsiston në vlerësim të realizimit artistik profesional dhe teknik të programit.</li> </ul> <p>(6) Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit dhe pësja që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit në fillim të semestrit.</p> <p>(Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UART/FM/DI harton rregullore dhe procedura të posaçme të kontrollit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>						
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="632 1603 810 1682">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="810 1603 1003 1682">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1003 1603 1206 1682">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="632 1682 810 1751"></td> <td data-bbox="810 1682 1003 1751"></td> <td data-bbox="1003 1682 1206 1751" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas Rregullores Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 42 “<i>Format e kontrollit</i>”, pika 6 përcakton se “<i>Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit në fillim të semestrit</i>”. (Dokumenti 41/I.1.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Referuar programeve lëndore (syllabuseve) të cilat zhvillohen në programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, në veçanti kategorisë “<i>Kontrollit të njohurive</i>”, vërehet se janë përshkruar forma të tilla si: mbrëmje muzikore, saxho, kontroll teknik, esse, detyra, projekt, kolokium, provim, firmë, koncert, etj. Në tërësi, procesi i vlerësimit përfshin <i>kontrollin e vazhdueshëm të njohurive, kontrollin e ndërmjetëm dhe kontrollin përfundimtar</i>. Vlerësimi përfundimtar bazohet në disa elemente, kombinimi i të cilave varion sipas specifikës së lëndës/modulit, si: frekuentimi dhe diskutimi në seminar, detyra kursi dhe provimi përfundimtar; ose pjesëmarrja aktive në orën e mësimi, puna e pavarur krijuese, detyrat e kursit, projektet e kursit, provimi përfundimtar; ose ushtrime, praktika, esse dhe provimi përfundimtar; ose punë individuale, kontroll teknik, saxho dhe provim; ose pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim, punë individuale, ushtrim dhe provim përfundimtar; ose pjesëmarrje dhe angazhim në mësim, punë e pavarur, koncert dhe provim-koncert, etj. Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një rreze të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlloritet nga 30% – 80% të vlerësimit total. Përrjashtim bën vetëm një lëndë (fq. 79) ku provimi final llogaritet 100% në vlerësimin përfundimtar. Rezultati përfundimtar konvertohet në note. (Dokumenti 4/04 SYLABUS KITARE.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, staf akademik shpjegoi se vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë si dhe ta ndihmojë atë hap pas hapi që të përmirësohet, si dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të</p>	<p>Institucioni nuk ka sistem elektronik për testimin dhe vlerësimin.</p>

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sipas RVB (2022), në rastin e programit të studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi “sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit nuk janë të përshtatshme për të matur aspektin cilësor të interpretimeve, aspektin kreativ, apo atë të lojës në ansambël”. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Për të shmangur format e abuzimit dhe rritur transparencën për testimin dhe vlerësimin e studentëve, UART/FM/DI zbaton procedura korrekte të përshkruara në rregulloret përkatëse, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndët profesionale artistike me interpretim muzikor në kohë reale realizohen me prezencë publiku, pra, jo me dyer të mbyllura, duke shmangur kështu format e abuzimit ose subjektivizmit;</li> <li>- Lëndët teorike të cilat parashikojnë provimin me shkrim, në momentin e marrjes së tezës së provimit, sekretojnë emrin e studentit në mënyrë që komisioni i provimit të jetë sa më objektiv gjatë procesit të kontrollit dhe vlerësimit.</li> <li>- Vetëm pas kontrollit nga komisioni dhe vendosjes së vlerësimit, nga sekretaria bëhet zbulimi i emrit dhe vendosja e vlerësimit në listën respektive të studentëve.</li> <li>- Studentët kanë të drejtë të kërkojnë verifikim, në rast se nuk janë dakort me vendimin dhe vlerësimin e komisionit.</li> <li>- Rezultatet e testimit dhe vlerësimit të studentit/es, kanë një afat 5 ditor për komunikimin e rezultatit. Në vijim vendosen nga kryetari/ja e komisionit të provimit aktualisht në sistemin PITAGORA (ish ESSE3), duke ia bërë të njohur në kohë reale këtë rezultat studentit/es së interesuar.</li> </ul> <p>(Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf; Dokumenti 74/III.3.2.2 foto sekretimi i fletes se provimit.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas Rregullores Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 41 “Mënyrat e të provuarit të dijes”, pika 3, shprehet se “Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë, apo modul të caktuar merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, labororet, kontrollet e pjesshme, frekuentimi, etj. Shkalla e rëndësisë së secilit element në vlerësimin përfundimtarështë e lidhur me peshën që zenë ato në ndarjen e kreditevetë lëndës sipas veprimtarive formuese të saj, të përcaktuar në planin mësimor dhe në programin e lëndës”. (Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), neni 17, pika (2) shprehet se “Në rastin e organizimit të moduleve të përbëra ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë. Në të dyja rastet, vlerësimi</p>

	<p>përfundimtar shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë vlerësimi dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer. (3) Në syllabusin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit të saj”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në RVB (2022), institucioni raporton se <i>vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente e diskutime të hapura përpara të gjithë grupit të studentëve dhe lidhet me këshilla të vlefshme nga artistët e afirmuar (të cilët përbëjnë personelin pedagogjik akademik) mbi procesin e të nxënit dhe ndihmën për të projektuar punën në të ardhmen.</i> (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf). Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar shoqërohet me komente/feedback/këshilla me qëllim që ta ndihmojë atë të përmirësohet në ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 20, pika 9 shprehet se “<i>Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve. Studenti që përdor forma dhe mjete të palejueshme, largohet nga provimi dhe konsiderohet i vlerësuar negativisht</i>”. Neni 29, pika 5, përcakton se “<i>Punimi teorik i diplomës nuk duhet të përmbajë elementë të plagjiaturës. Për këtë arsye studenti duhet të vetëdeklarojë me shkrim mungesën e plagjiaturës në punimin teorik</i>”. Neni 44, gërma (g) thekson se “<i>Studentët duhet të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor ...</i>” (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, nga takim me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se plagjiatura apo kopjimi në provime mund të shmanget në FN, sepse stafi respekton dhe zbaton me korrektesë rregullat lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kushtet e sekretimit të tezës së provimit nga sekretaria mësimore,</li> <li>- monitorimin e procesit të provimit nga komisioni i përbërë nga pedagogë të lëndës,</li> <li>- moslejimin e përdorimit të së njëjtës tezë provimi me grupe që zhvillojnë provim në orare të ndryshme,</li> <li>- mospërsëritjen e së njëjtës tezë brenda të njëjtë vit akademik (përfshirë edhe sezonin e riprovimit), etj.,</li> <li>- sipas specifikës së lëndës, zhvillohet proces testimi duke luajtur koncert/musical live,</li> </ul> <p>Përsa i përket shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik shprehet se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi</p>

	ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni.
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>FM/DI bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë.</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 20, pika 10 përcakton se “Provimet me shkrim bëhen të sekretuara dhe zgjasin 2-4 orë ... Pika 11 specifikon se “Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme, shtyrja e dates së dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit”. Neni 21, pika 4 shprehet se “Në përfundim të provimit, kryetari i komisionit të provimit në praninë e anëtarëve të komisionit, bazuar në manualin e hedhjes së notave në sistem nga pedagogët, aksesohet në sistemin PITAGORA, në llogarinë personale dhe cakton në Proces Verbalin e Provimit digjital, vlerësimin e komisionit për secilin prej studentëve, në përputhje me Fletën e Provimit. Proces Verbali i Provimit shkarkohet nga kryetari i komisionit të provimit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët”. Pika 5 cilëson se “Proces Verbali i Provimit, i plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dhënies së provimit”. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Në programin lëndor (syllabusin), në seksionin “Forma e kontrollit”, është përfshirë një tabelë e detajuar pikëzimi për vlerësimin e studentëve, të ndarë në kategori: nota numerike, nota me shkronja sipas ECTS, shkalla e suksesit të pikëve shprehur në %, përkufizimi/përshkrimi i notës me fjalë dhe shprehje. (Dokumenti 4/04 SYLLABUS KITARE.pdf).</p> <p>Zbatimi me korrektesë i procedurave të marrjes në provim dhe kontrollit të dijeve, si dhe aplikimi i një sistemi të detajuar pikëzimi në vlerësimin përfundimtar të lëndës/modulit tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të bazuara në meritë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>UART/FM/DI garanton bazuar në dokumentet rregullatore, të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës.</p> <p>Sipas Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore të Fakultetit të Muzikë (2021), Neni 45, pika 13 shprehet se “Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke</p>



	<p>ballafaquar përgjigjen e dokumentuar apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur”. Pika 14 e këtij neni, përshkruan se “Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i njësisë bazë, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit”. Në pikën 15 specifikohet se “Studenti ka të drejtë të ankohe, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamertuar për përgjigjen që ka dhënë ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit, në Dekanat. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin, dhe pas gjyqimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve”. (Dokumenti 86/VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p>						
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore të Fakultetit të Muzikë (2021), Neni 45, pika 16 shprehet se “Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentit është ankuar dhe vendos që studentit të jape përsëri provimin, me të njëjtin komision ose me një komision të ridhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve”. (Dokumenti 86/VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Rregullorja mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 21, përcakton procedurat e dokumentimit dhe arkivimit të vlerësimit të studentëve, duke përfshirë dhe rastet e parregullsive të mundshme. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UART/FM/DI siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1668 790 1736">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="790 1668 981 1736">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="981 1668 1189 1736">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1736 790 1792"></td> <td data-bbox="790 1736 981 1792"></td> <td data-bbox="981 1736 1189 1792" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta artistike e shkencore të studentëve.</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 1, <i>“Programi i ciklit të dytë të studimeve është riorganizuar, për t’ju përgjigjur më mirë nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndët e muzikës pranë institucioneve arsimore të të gjitha cikleve”</i>. Sipas përcaktimeve të Nenit 7 të këtij dokumenti, mes të tjerash theksohet se <i>“Gjatë studimit të programit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, përpos zhvillimit të aftësive për aplikimin e teknikave bashkëkohore në Interpretim, synohet edhe rritja e kapacitetit të studentit në ilustrimin verbal dhe me shkrim, të koncepteve bazë të teorisë së muzikës dhe teknikave analitike. Kjo sigurohet nëpërmjet studimit të thelluar të veprave, kompozitorëve dhe stileve të ndryshme...Përmbajtja e programit të studimit vjen si vazhdimësi logjike e programit të ciklit të parë Bachelor në Kitarë Klasike dhe synon thellimin e njohurive të studentit dhe zhvillimin e personalitetit krijues artistik. Njëherazi, programi i studimit... ka pasuruar përmbajtjen me lëndë që rrisin aftësitë pedagogjike të studentit. Nëpërmjet këtyre lëndëve, studentët e këtij programi, thellojnë formimin e tyre si mësimdhënës në fushën e muzikës”</i>. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>UART/FM dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimit jashtë orëve mësimore për të përdorur sistemin “Pitagorë” me qëllim realizimin e komunikimit elektronik. (Dokumenti 72/III.2.1.1 Manual - studenti ne sistemin Pitagorë.pdf).</p> <p>Referuar Planit Mësimor (2021-2022), vërehet se në grupin e lëndëve me zgjedhje, ofrohet edhe lënda “Informatikë e aplikuar (regjistrim audio)” e cila realizohet me 4 kredite, me shtrirje gjithëvjete, në dy vite akademike (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitare-21-22.pdf). Informatika e aplikuar është një disiplinë që përfshin aspekte të sintezës së zërit, përpunimit dhe transformimit të tij. Ajo aftëson studentin në kompozimin muzikor ose siç quhet ndryshe “kompozim muzikor pa ndihmën e njeriut” (fq.89). (Dokumenti 4/04 SYLABUS KITARE.pdf).</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik tregoi se studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë informatike ndërkohë që realizojnë detyra mësimore, ushtrime praktike të lëndëve speciale, apo kur zhvillojnë aftësi hulumtuuese/ studimore artistike në fushën e muzikës dhe mësimdhënies.</p> <p>Në Planin Mësimor (2021-2022), janë përfshirë edhe lëndë nga fusha e psikologjisë dhe komunikimit të cilat sipas RVB (2022) synojnë të plotësojnë formimin e figurës së artistit të ardhshëm <i>Kitarist</i> si dhe i <i>garanton</i>, veç të tjerash edhe <i>një zhvillim të balancuar të formimit të tij</i>, sa artistik, aq dhe human apo me impakt social. (Dokumentit1/05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>DI, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës. Në fund të semestrit, DI kërkon nga pedagogu i çdo lënde apo moduli të raportojë në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës, si dhe të paraqesë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundëshme përfshihen në raportin e analizës vjetore të departamentit. (Dokumentit 44/ I.1.3.1.15 - Analize vjetore DI.pdf).</p> <p>Kjo praktikë vlerësohet nga GVJ si një tregues pozitiv i angazhimit institucional për të inkurajuar personelin akademik të analizojë, shqyrtojë dhe reflektojë mbi objektivat përkatëse, të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen lëndore dhe metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të hartojë programe lëndore që thelbësisht synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p> <p>Në RVB (2022) institucioni raporton se “Për vetë natyrën specifike të organizimit të mësimin në këtë program studimesh, mbështetur në VKM Nr.145 datë 10.03.2021, <i>Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë</i>, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të zhvillimit të lëndës”. (Dokumentit1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se ata punojnë me studentin në mënyrë të tillë që të zhvillojnë një figure të balancuar të instrumentistit kitarist, duke analizuar nevojat, potencialet dhe ecurinë artistike të studentit. Gjatë këtij procesi, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentin për zbatimin e tyre. Gjithashtu, stafi akademik tregoi se pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit, para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar. Në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/ në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre.</p>

**Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.

Stafi akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash, duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore (syllabuseve) dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritëshme të të nxënit (në seksionin "Korrelacioni me programin studimor" ose "Objektivat e lëndës") që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor. Gjenden shembuj të mirë të formulimit të rezultateve të pritëshme të të nxënit, ku përdoren folje të matëshme, të tilla si: - të identifikojë, të dallojë, të krahasojë, të diskutojë, të demonstrojë, të përdorë, të shkruajë, të hartojë, të interpretojë, të realizojë, të planifikojë, të analizojë, të argumentojë, të vlerësojë, të aplikojë, etj., duke vënë theksin tek demonstrimi/përdorimi/aplikimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave në situata praktike. (Dokumenti 4/04 SYLABUS KITARE.pdf, fq. 3, 12, etj.). Ndeshen edhe raste të programeve lëndore të paplota ose që nuk janë evidentuar qartë rezultatet e pritëshme ose që përdoren formulime të përgjithëshme, të tilla si: të njohë, të thellojë kuptimin/dijet, të zotërojë, etj, të cilat duket se orientojnë më tepër studentët te përfitimi i njohurive, sesa demonstrimi i aftësive dhe kompetencave të tyre në situata praktike. (Dokumenti 4/04 SYLABUS KITARE.pdf, fq. 24, 34, etj.). Në këtë aspekt, sugjerohet të rishikohet formulimi i rezultateve të pritëshme të të nxënit duke specifikuar aftësitë dhe kompetencat që duhet të demonstrojnë / përdorin / aplikojnë studentët në situata praktike në përfundim të programit lëndor.

Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik shpjegoi se leksionet, seminarët dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke ju dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme profesionale në situata praktike. Stafi akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: punë në grupe, diskutim, interpretim, analiza, reflektim, etj. Përsa i përket aspektit metodologjik të mësimdhënies, shumica e titullarëve të lëndëve treguan se ata kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxënit e studentëve duke e bazuar në diskutime që nxisin mendimin kritik, kombinime të punës individuale dhe asaj në grup, ushtrime praktike ku gjejnë zbatim dijet e fituara, interpretimin artistik dhe zgjidhje të çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën.

Sipas RVB (2022), anëtarët e personelit akademik të cilët drejtojnë lëndë kolektive interpretative sipas planit mësimor të miratuar, krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështesin ato si Departament.

	Gjithashtu, praktikat mësimore dhe ato artistike janë dy elementë të tjerë që i shtohen lëndëve praktike me instrument, të cilat në mënyrë integrale paraqesin interes për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve në institucionet bashkëpunuese. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).		
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik efektiv dhe ose me kontratë i Departamentit të Interpretimit dëshmon se realizon interpretime artistike dhe diskutime të hapura për publikun mbi zhvillimet e reja të muzikës bashkëkohore, në evente koncertale, brenda/jashtë strukturës së programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”. (Dokumenti 35/ I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takimee etj.pdf). Gjithashtu, studentët pohuan gjatë takimit me GVJ se institucioni organizon veprimtari jashtë programit mësimor me karakter kulturor, shkencor dhe zbavitës.		
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. FM/DI inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore dhe artistike në bashkëpunim me pedagogët e tyre. GVJ evidentoi se institucioni mbështet bashkëpunimin me studentën në kuadër të ngjarjeve shkencore e artistike në nivel kombëtar/ndërkombëtar, organizuara nga UART/FM ose në partneritet me institucione të tjera, duke nxitur dhe mirëpritur pjesëmarrjen e studentëve në interpretime muzikore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. (Dokumenti 35/ I.I.2.5.2 foto nga koncerte, masterclasse, takimee etj.pdf). Përsa i përket mbështetjes financiare nga ana e institucionit për zhvillimin e ideve inovative apo studimeve të përparuara kërkimore nga studentët, institucioni raporton se realizimi kryhet në mënyrë indirekte, pasi investimet e kryera, janë në dobi të të gjithë studentëve krijues apo interpretë të cilët trajtojnë elementë të inovacionit dhe studimeve kërkimore në fushën e muzikës bashkëkohore. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).  Sipas Rregullores së Universitetit të Arteve (2021), Neni 125 shprehet se “Veprimtaria e Këshillit të Studentëve të UART financohet dhe mbështetet nga buxheti i UART mbi bazën e parashikimeve në buxhet”. (Dokumenti 23/I.I.1.3.7 Rregullore e Universitetit të Arteve VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF).		
<b>Konkluzione</b>	Programi i studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi III.5****Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.****Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.

Institucioni ka hartuar dhe publikuar rregullore të posaçme për programin e studimit të marrë në vlerësim, dhe ndjek procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse para realizimit të tyre. Dokumenti Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), është publik për të gjithë studentët. Në kreun VIII të këtij dokumenti “Për Diplomimin”, nga Neni 29 deri tek Neni 36, janë përshkruar procedurat e posaçme për detyrimet përmbyllëse. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).

Kriteret për fitimin e diplomës dhe procedurat e diplomimit janë përcaktuar edhe në dokumente të tjera të institucionit, si: Rregullore e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Rregullore e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Departamentit të Interpretimit (2022), Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), dhe Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi (2022). (Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf; Dokumenti 88/VSA\_45 Rregullore e Departamentit Interpretim FM.pdf; Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF; Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).

**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.

FM/DI, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse dhe mbrojtjes së diplomës.

FM ka publikuar Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021) dhe Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi (2022) që përbëjnë dokumente rregullatore të posaçme të cilat përcaktojnë standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë të marrë në vlerësim. (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF; Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).

Gjithashtu, DI ka përgatitur edhe një Udhëzues të thjeshtë për hartimin e diplomës/mikrotezës, në format shumë të shkurtër, që lejon studentët të informohen rreth kërkesave teknike dhe standardet e punimit /mikrotezës së diplomimit. (Dokumenti 5/UDHEZUES pËr DI.pdf).

	<p>Sipas Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 39, përcakton se (1) “Në Universitetin e Arteve ka një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitetet e ndryshme të procesit mësimor, etj. (2) Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma: (a) format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve; (b) në format elektronik në faqen zyrtare në rrjetë të UART i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët; (c) të shpallura në mjediset e Fakulteteve përkatëse.</p> <p>Bazuar në Nenin 40, të Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), FM/DI ka caktuar një Këshilltar Akademik për çdo student të programit të studimit, i cili është përgjegjës për të monitoruar ecurinë e studentit gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në UART, për ta orientuar, asistuar dhe këshilluar, etj., si dhe për të siguruar që studenti disponon të gjithë informacionin dhe dokumentacionin ndihmues përkatës. (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</p> <p>Sipas RVB (2022) institucioni angazhon edhe një Specialist për Informimin e Studentëve, i cili siguron çdo informacion të nevojshëm në lidhje me procesin administrativ të zhvillimit të detyrimeve përmbyllëse. (Dokumenti 1/05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në Rregulloren mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 29, pika 1, shprehet se “Në përfundim të programit të studimit, studentët diplomohen në programin Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi. Provimi i diplomës kryhet nëpërmjet paraqitjes së tezës së diplomës dhe mbrojtjes artistike të krijimtarisë muzikore”. Pika 6 e këtij neni shprehet se “Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një programi artistic (vepra muzikore) dhe të një studimi mbi programin artistic. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore projektuese artistike, të tregojë aftësitë e tij profesionale-artistike dhe kompetencën për të kryer studime, projekte, dhe realizime artistike në fushën përkatëse”. (Dokumenti 25/I.1.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), programi i diplomës udhëhiqet nga pedagogu i dhe është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- një punim teorik – tezë, për t’u paraqitur para komisionit të posaçëm;</li> </ul>

	<p>- pesë vepra të përcaktuara nga pedagogu i lëndës (speciale) nga lista e literaturës bazë ... miratuar nga kryetari i grupit mësimor, përgjegjësi i Departamentit të Interpretimit...</p> <p>Mbrojtja e Diplomës realizohet me publik në sallë. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Sipas Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 32 specifikon se (3) <i>“Punimi i diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm, i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të propozuar nga DI dhe të miratuar nga Dekani i FM”</i> (5) <i>“Mbrojtja e diplomës është publike”</i>. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 31, pika 6, shprehet se <i>“Përgjegjësi i njësisë bazë bën propozimin e temave dhe programeve të diplomës, si dhe udhëheqësve, të cilat miratohen nga Dekani jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e fillimit të vitit akademik”</i>. (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</p> <p>Referuar Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 31, shprehet se (1) <i>“Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit dhe përcakton programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfunimit të çdo pike të programit... (2) Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar... (3) Udhëheqësi mban shënimet përkatëse në lidhje me ecurinë e studentit në përgatitjen e tezës /mbrojtjes artistike të diplomimit. (4) Njësia bazë rrganizon kontrole periodike, në të cilat kontrollohet volume i punës së kryer dhe cilësia e kryerjes së tyre. Përgjatë këtyre kontroleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të tezës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit. (5) Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës. Udhëheqësi jep mendimin e tij dhe deklarohet se volume i planifikuar i punës është kryer dhe student i është gati për mbrojtjen e tezës së diplomimit dhe më pas të mbrojtjes artistike të saj”</i>. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Bazuar në përcaktimet e mësipërme, dëshkohet se personeli akademik/udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi e asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuara. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>FM/DI asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore dhe artistike. Sipas Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 31, pika 4, shprehet se “Në përcaktimin e temave/programave të diplomës, njësia bazë mund të bashkëpunojë dhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse”. (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, autoritetet drejtuese treguan se FM/DI u asiston studenteve brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në biblioteke, mjedis të mbuluar me WiFi, etj.</p> <p>Megjithatë, në RVB (2022), institucioni deklaroi se “Në lidhje me kriterin 5 të Standardi III.5, mund të thuhet se është një kriter i pamundur për t’u aplikuar për specifikën e institucionit, si dhe për fushën e studimit të tij”. (Dokumenti I/05 RVB KITARË.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë. Ky kriter gjen pasqyrim në Rregulloren Mësimore të Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 34, pika 1, ku deklarohet se “Në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit, mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë për çdo diplomant duke e nënshkruar atë. Komisioni pasi bën mesatarizimin e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe në prani të tyre, plotëson proces verbalin e provimit të diplomës. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkangjitet proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin regjistrohet nota përfundimtare dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore të fakultetit.” (Dokumenti 94/Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.PDF; Dokumenti 73/ III.3.2.1 Procesverbal mbrojtje diplome violonçel dhe mësuesi.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 34, pika 1, përcakton se “<i>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës</i>”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai lëshohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), dhe përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit ...Përmbajtja dhe forma suplementit të diplomës përcaktohen në Statutin e UART, në përputhje</p>

	<p>me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. (Neni 102, Dokumenti 21/I.I.1.2.1 Statuti_uart_2021.PDF).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se kopja zyrtare e programit të studimit, përfshin syllabuset e këtij programi. Ajo vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Supplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p> <p>Përmbushja e kriteri 7, dëshmohet edhe nga dokumentet që institucioni ka depozituar në e-ASCAL. (Dokumenti 76/ III.5.7.3 Udhezim per suplement diplome.pdf; Dokumenti 89/ III.5.7.1. Model suplementi diplome.pdf).</p>				
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UART/FM ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p> <p>Në RVB (2022), institucioni raporton se dokumentacioni i studentit është i mundshëm për të verifikuar sipas rastit dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar <i>Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</i>. (Dokumenti1/05 RVB KITARË.pdf).</p> <p>Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FM disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Rregulloren e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART (Dokumenti 85/ Rregullore e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.PDF) dhe procedurat përkatëse mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë të të dhënave personale. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, një kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore. Nga takimi me drejtuesin e DI, u dëshmuua se kjo njësi ruan kopjet e dorëzuara të punimit të diplomave që studentët mbrojnë para komisionit, në versionin hardcopy dhe elektronikisht (CD). (Dokumenti 4/ Punim teorik kitare.pdf, Seksioni: Vizita dy ditore në IAL dhe informacioni shtesë).</p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="598 1892 798 1966">Përmbushet plotësisht</td> <td data-bbox="798 1892 997 1966">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="997 1892 1197 1966">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1197 1892 1433 1966">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>FM/DI në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garanton mjedise brenda dhe jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e ushtrimeve/praktikës artistike dhe praktikës profesionale të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të vëzhgonte disa nga klasat dhe sallat ku studentët e programit të studimit të marrë në vlerësim, zhvillojnë mësim praktikë dhe ushtrohen me instrumente.</p> <p>Ndërsa, praktikat profesionale të mësimdhënies realizohen në bashkëpunim me ZVA ose shkollat artistike në vend. (Dokumenti 55/I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf; Dokumenti 56/I.I.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>UART/FM/DI, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave profesionale me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale të studentëve të programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi.</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi" (2022), Neni 28, shprehet se (3) "<i>Praktikat mësimore zhvillohen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar nën drejtimin e personelit akademik të caktuar nga DI. Zhvillimi i tyre bazohet në aktmarrëveshjet ndër-institucionale ku parashikohen detyrimet dhe të drejtat e secilës palë ...</i> (4) <i>Personeli akademik që e drejton atë, mban lidhje me institucionin ku ajo (praktika) kryhet për secilin student.</i> (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitare.pdf).</p> <p>Praktikat profesionale të mësimdhënies realizohen në bashkëpunim me ZVA ose shkollat artistike në vend. (Dokumenti 55/I.I.3.3.1 Tabela 5 Marreveshjet.pdf; Dokumenti 56/I.I.3.3.2 Marreveshje FM me ZVA Vlore.pdf).</p> <p>Sipas Ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "<i>Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë</i>", Neni 8, pika 1, të diplomuarit në programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, kandidatë për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit, duhet: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në UP-në përkatëse, që në rastin e mësuesit</p>

	<p>janë Drejtoritë Arsimore Rajonale. <a href="https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRR1.pdf">https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRR1.pdf</a></p> <p>(Dokumenti 12/I.I.1.1.5 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-MESUESIT.pdf).</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Në dokumentit “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës” (2021), Neni 28, pika 3, shprehet se “Për mbikqyrjen e zhvillimit të praktikës mësimore, përgjegjësi i departamentit emëron pedagogun që do të ndjekë, vlerësojë dhe plotësojë dokumentacionin e praktikës mësimore ...” Dokumenti 41/I.I.3.1.12 VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” (2022), Neni 28, shprehet se (2) “Praktika mësimore është pjesë e kurrikulës për programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, për drejtimin e mësuesisë dhe përmban një numër të caktuar kreditesh”. (5) “Në përfundim të praktikës profesionale, studenti vlerësohet me notë ose me vlerësim pozitiv/negativ sipas përcaktimit në syllabusin e lëndës”. (Dokumenti 25/I.I.1.3.9 Rregullore programi Kitarë.pdf).</p> <p>Referuar Planit Mësimor (2021-2022), praktika mësimore (artistike dhe mësimdhënëse) përfshin 11 kredite. (Dokumenti 3/ 03 Plan mesimor kitarë-21-22.pdf).</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Në rastin e programit të studimit “Master Profesional” në Kitarë dhe Mësuesi, institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës ushtrimore/artistike dhe praktikës profesionale mësimdhënëse.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” të ofruar nga Departamenti i Interpretimit (DI) në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, grupi i RVJ-së konstatoi se personeli akademik efektiv dhe me kontratë dhe personeli ndihmës akademik që angazhohen në këtë program, përmbush kërkesat ligjore për nivelin e duhur të kualifikimit akademik të stafit, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit.<sup>1, 2, 3, 4, 5</sup></p> <p>Në lidhje me këtë program studimi, fusha kërkimore bazohet në specifikat e moduleve dhe përcaktohet në këto dokumente: Rregullorja e Studimit të Ciklit të Dytë të Studimeve, dhe Statuti i UART.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura nga DI qartësohet se për realizimin e ngarkesës mësimore për programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, angazhohet personel efektiv i brendshëm (10 pedagogë) dhe 3 pedagogë PAK (të jashtëm) për plotësimin e ngarkesës mësimore dhe është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018, Kreu II, Pika 1, 2, 6, 7, 10, 12 dhe pasqohet në Evidencën IV.1.1.8.<sup>6</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Raporti i RVB-së për këtë program studimi theksonte se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ka nënshkruar kontratat me UART sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.<sup>7</sup> Dhe UART paguan rregullisht të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore shëndetësore të stafit akademik.</p> <p>Grupi i RVJ-së pasi shqyrtoi dokumentet e paraqitura nga përfaqësueset e BNJ të FM, konstatoi se në dosjen e paraqitur, ndër të tjera, ishin të</p>

<sup>1</sup> Ligji 80/2015 “Per Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Dokumenti I.I.1.1.1.

<sup>2</sup> Udhëzim Nr. 29, datë 10.09.2018 “Per veprimtarinë dhe ngarkesën mesimore të personelit akademik në IAL”. Evidenca IV.1.1.2.

<sup>3</sup> VKM, Nr. 145, datë 10.03.2021 “Per dhenien e statusit të veçantë të Universitetit të Arteve”, Evidenca I.I.1.1.1.

<sup>4</sup> Statuti i UART, Evidenca I.I.1.2.1.

<sup>5</sup> Rregullore e Programeve të Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, Evidenca 3.

<sup>6</sup> Tabela 6.3 dhe Tabela 7, Evidenca IV.1.1.8.

<sup>7</sup> Statuti i UART, Evidenca I.I.1.2.1.

	përfshira një model marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe një Kontrate punësimi të një anëtarë të DI, të cilat vertetonin qëndrueshmërinë e personelit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga RVB-ja rezultoi se në DI, ku ofrohet programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ndiqen procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kriteret e përgjithshme hartoheshin nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ndërsa ato specifike nga Njësia bazë DI. Të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit bëheshin konform rregullores dhe shpalleshin publikisht duke përfshirë dhe kandidatin fitues. <sup>8</sup> Nga takimet e zhvilluara gjatë vizitave në institucion, por dhe nga Raporti vjetor i UART për vitin akademik 2020-2021 <sup>9</sup> , DI ka rekrutuar 5 pedagogë të rinj me kohë të plotë, ndërsa pedagog për kitarë nuk ka patur nevojë të rekrutojë, sepse ka personel të mjaftueshëm.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Grupi i ekspertëve gjatë vizitës në institucion nga bisedat me përfaqësues të DI-së konstatoi se për vetë specifikat që ka Fakulteti i Muzikës dhe DI, si laboratorë konsideroheshin mjediset që përdorëshin për lëndë individuale ose në grup, ndërsa si laborator standard konsiderohej Laboratori i Audios. UART përcaktonte angazhimin e stafit ndihmës mësimor akademik, si pjesë e njësisë bazë të tij, të mbështetur në Statutin e UART <sup>10</sup> . Funkcionet institucionale të stafit ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike, përcaktoheshin edhe në Rregulloren e FM. <sup>11</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	U evidentua se Universiteti i Arteve mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” duke u mbështetur në Statutin e UART (Neni 61, Pika 1, 2). Drejtorja e Burimeve njerëzore na ofroi dosjet e personelit akademik dhe konstatoam se kjo njësi i ruante të gjithë dokumentacionet si të stafit të brendshëm akademik ashtu edhe atij ndihmës dhe administrativ.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të	Nga analiza e evidencave të dorëzuara nga institucioni në sistemin AMS, grupi i RVJ-së evidentoi se Univesiteti i Arteve, FM kishte

<sup>8</sup> Statuti i JART, Evidenca I.I.1.2.1. Neni 56 dhe 57.

<sup>9</sup> Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021, fq. 31. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

<sup>10</sup> Statuti i UART, Evidenca I.I.1.2.1. Neni 69, pika 2 dhe 3.

<sup>11</sup> Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Muzikës, Neni 7. Evidenca I.I.3.1.12.

<p>lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>lidhur marrëveshje me ZVA Tiranë dhe Vlorë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve.<sup>12</sup> Në këtë dokument, përcaktohen detyrimet e FM dhe Njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës për të ndjekur praktikën profesionale të studentëve. Po ashtu, në Nenin 28 të Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”<sup>13</sup> përcaktohet qartë mënyra e vendosjes së personelit të kualifikuar për udhëheqjen e praktikës mësimore. Ndërsa në lidhje me udhëheqjen e punimeve të diplomave dhe veprimtarive të tjera specifike sipas programit të studimit, edhe kjo detyrë përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit, Neni 29, Pika 4.</p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>RVJ, në lidhje me plotësimin e kriterit 8, shprehet se detyrimet e angazhimit të personelit pritës të studentëve për realizimin e praktikave profesionale ishin të përcaktuara në akt marrëveshjen e lidhur ndërmjet UART dhe ZVA Vlorë dhe ZVA Tiranë. Në këtë marrëveshje, institucioni pritës merrte përsipër:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mundësimin e zhvillimit të praktikave në këtë shkollë;</li> <li>- caktimin e një mësues mentor të studentit praktikant;</li> <li>- vënie në dispozicion të studentëve materiale dhe mjete ndihmëse;</li> <li>- angazhimin e studentëve praktikantë sipas nevojave që i paraqitej institucionit;</li> <li>- dhënien e mendimeve për vlerësimin e punës së studentëve.</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri IV.1 përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet</b> <b>gjësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet</b> <b>kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet</b> <b>plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet</b> <b>plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>				
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se mjediset për zhvillimin e veprimtarive mësimore ishin të përshtatshme. Për vetë specifikën e zhvillimit të procesit mësimor në këtë fakultet dhe program studimi, mësimi i instrumentit muzikor zhvillohej një pedagog - një student. Fakulteti i Muzikës vinte në dispozicion gjithë kapacitetet infrastrukturore në funksion të plotë të krijimit të kushteve të duhura si për lëndët muzikore-artistike, ashtu edhe për lëndët pedagogjike.</p>			

<sup>12</sup> Marrëveshja e FM dhe ZVA Vlorë, Evidenca I.I.3.3.2.

<sup>13</sup> Rregullore e Programeve të Ciklit të Dytë, Master Profesional në ‘Kitarë dhe Mësuesi’, Neni 28. Evidenca 3.




specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej Departamentit të Interpretimit: të Fakultetit të Muzikës, rezultoi se për vetë specifikën që kishte programi i studimit Master Profesional “Kitarë dhe Mësuesi”, lëndët individuale nuk kishin nevojë për mjedise me pajisje elektronike dhe TIK. Ndërsa për lëndët kolektive vihej në dispozicion Lektoriumi “Tonin Harapi”, i cili ishte i pajisur me pajisje të TIK-ut. <sup>14</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga bisedat e zhvilluara me anëtarët e DI, konstatohet se Studiot e Interpretimit: ishin të pajisuara me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kurrikulës së programit të studimit: “Kitarë dhe Mësuesi”.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Konstatohet se Fakulteti i Muzikës zotëron në mjediset e tij dy laboratorë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale. Nga vizita në institucion dhe sipas dokumentacionit të dorëzuar nga UART, FM dhe DI, na u sigurua se kompjuterat e laboratorit nr. 1 janë të pajisur me programin profesional Sibelius (për notizim digjital) dhe Steingerg Cubase (për regjistrim dhe përpunim audio) kurse Laborator i Tingullit ishte një studio e mirëfilltë ku realizohej regjistrimi dhe përpunimi audio. <sup>15</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën	Konstatohet se Fakulteti i Muzikës garanton zhvillimin e praktikave artistike në mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Këto praktika materializoheshin në realizimin e koncerteve, ku interpretoheshin vepra kombëtare ose ndërkombëtare me studentë të Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”. <sup>16</sup> Ndërsa për zhvillimin e praktikave profesionale ato realizoheshin në mjediset e institucioneve të arsimit parauniversitar ku FM kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione (Marrëveshja me ZVA Tiranë dhe Vlorë).

<sup>14</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në ‘Kitarë dhe Mësuesi’, fq.90. Evidenca 1.

<sup>15</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në ‘Kitarë dhe Mësuesi’, fq.90. Evidenca 1.

<sup>16</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në ‘Kitarë dhe Mësuesi’, fq.90. Evidenca 1.



mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se, bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, standardi IV. 2 përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Fakulteti i Muzikës, konstatohet që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve kitaristë në gjuhën shqipe (fizike dhe/ose digjitale për Modulin A, C) dhe në gjuhën universale të muzikës (fizike dhe digjitale për Modulin B) përmes Syllabuseve të Planit Mësimor të Programit të Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme. Literatura Bazë dhe ndihmëse ofrohet dhe gjendet fizikisht në formë tekstesh dhe partiturash pranë Bibliotekës së UART ose fizikisht në formë leksionesh nga pedagogët e lëndëve; dhe në menyrë digjitale përmes lidhjeve të faqeve të internetit që mund të aksesoheshin. <sup>17</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DI , ku ofrohet Programi i Studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, konstatohet që bëheshin përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit. Nga bisedat me pedagogët e këtij program studimi u evidentua se përditësimi i literatures realizohej edhe nga botimet e partiturave muzikore mbi bazen e dorëshkrimit origjinal, përshtatjeve të materialeve të ndryshme muzikore për instrumentin kitarë, si dhe duke marrë parasysh edhe veçoritë individuale të studentëve kitaristë. <sup>18</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në Institucion u konstatua se Biblioteka Shkencore e UART garantonte mundësi të barabarta shfrytëzimi të fondit të saj për të gjithë studentët e Universitetit të Arteve, përfshirë këtu edhe studentët kitaristë nëpërmjet: -hapjes së një karteje anëtaresimi në BSHUA apo -hapjes së një llogarie online për Arkivin digjital të BShUA.

<sup>17</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” fq.90-91. Evidenca 1.

<sup>18</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, fq.90-91. Evidenca 1.

	<p>Biblioteka kishte dy salla që viheshin në dispozicion të studentëve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Salla e leximit me një kapacitet prej 30 vendesh dhe tre kompjuterash.</li> <li>2. Salla multimediale me një kapacitet prej 20 vendesh dhe 20 kompjuterash për secilin vend.</li> </ol> <p>Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Shkencore në UART përcaktohej në rregulloren e saj të miraturuar nga Senati Akademik.<sup>19</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Informacioni lidhur me bibliotekën e UART, na u përcoll nga drejtoresha e saj, punonjëse në këtë bibliotekë që prej 34 vitesh. Sipas këtij informacioni dhe vizitës në mjediset e brendshme të bibliotekës, deklarohet se Biblioteka e UART është biblioteka e vetme e Artit që ekziston në Shqipëri. Biblioteka kishte një histori prej 60 vitesh, që nga themelimi i Fakultetit të Muzikës, gjatë të cilave ajo kishte pasuruar fondin e saj me dorëshkrime shumë të vjera, disqe, kasete, libra, punime diplomash, etj., të cilat ishin edhe në proces të digjitalizimit për t'ju vënë në dispozicion të të gjithë të interesuarve. Fondi i saj i mbyllur dhe ai i hapur, fizik dhe elektronik, ofronte për të gjithë studentët e UART dhe për studentët kitaristë, një fond jashtëzakonisht të pasur shqip dhe në gjuhë të huaj, me tekste, parte e partitura për zhvillimin e veprimtarive mësimore sipas natyrës dhe specifikes së programit të studimit "Kitarë dhe Mësuesi".</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Muzikës dhe Biblioteka e UART ofronin mundësi të shfrytëzimit të literaturës online pa pagesë për të gjithë studentët. Ata kishin mundësi të aksesoheshin në arkivën digjitale të BSHUA<sup>20</sup> dhe për vetë specifikat e programit të studimit "Kitarë dhe Mësuesi", të merrnin shërbime pa pagesë në IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY.<sup>21</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita e zhvilluar në Bibliotekën e Universiteti të Arteve, konstatoam se BSHUA kishte përveç sallës së leximit, edhe sallën multimediale, e cila ishte e pajisur me 20 kompjuter të vënë në dispozicion të studentëve të saj. Kompjuterët ishin të pajisur me programe kompjuterike (office, adobe premier, finale) dhe pajisje teknike si kufie, printer dhe scanner. Këto pajisje mundësonin jo vetëm leximin e veprës muzikore por edhe dëgjimin e interpretimit të muzikës nga të gjithë studentët e FM.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,</p>	<p>Nga vizita në institucion evidentohet se Biblioteka kishte të afishuar në një vend të dukshëm të saj oraret e shërbimeve sipas nevojave të studentëve. Këto orare përfshinin ditët gjatë zhvillimit të procesit mësimor (e hënë - e enjte: 08:00-19.00; e premte 08.00-16:00) ashtu</p>

<sup>19</sup> Statuti i UART, Neni 21, Pika 4. Evidenca I.I.1.2.1

<sup>20</sup> Katalogu online i BSHUA: <http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=344&niveli=60>. UART, RVB për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", fq. 93. Evidenca 1.

<sup>21</sup> IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY: [https://imslp.org/wiki/Main\\_Page](https://imslp.org/wiki/Main_Page).

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	edhe periudhat e sesioneve të provimeve, në të cilën biblioteka qëndronte e hapur më një orar më të zgjatur.		
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, konstatohet se Biblioteka e Universitetit të Arteve, Fakulteti i Muzikës si dhe Departamenti i Interpretimit ndjekin dhe raportojnë periodikisht për: cilësinë e fondit fizik dhe atij online të bibliotekës, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët, për kërkesat për tituj të rinj nga ana e DI, si dhe për performancën e personelit akademik, nëpërmjet komunikimeve zyrtare. <sup>22</sup>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri IV.3 përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga analiza e dokumentacionit të FM, konstatohet se Universiteti i Arteve disponon një sistem menaxhimi, nëpërmjet të cilit, administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi" nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës dhe specialistes për sistemin PITAGORA</li> <li>- Sektorit mesimor, të Kurrikulave dhe Informimit të studentëve,</li> <li>- Drejtoria e BNJ dhe Informacionit, Protokollit dhe Arkivës</li> <li>- Sektorit të Statistikes</li> <li>- Sektorit të IT</li> </ul>

<sup>22</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", fq. 94. Evidenca 1.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisionit të Marrëdhënieve me Studentet (Statuti UART Neni 30/d, Neni 34).</li> </ul> <p>Ndërsa përsa i përket menaxhimit elektronik të informacionit, ai realizohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faqja zyrtare e UART ne internet dhe rrjetet sociale <a href="http://www.uart.edu.al">http://www.uart.edu.al</a></li> <li>- Komunikimi permes postës zyrtare email</li> <li>- Sistemit PITAGORA</li> <li>- Platformës online TEAMS.<sup>23</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, u konstatua se UART, e mbështeste sistemin e brendshëm të menaxhimit në Statutin<sup>24</sup> e saj dhe e administronte informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, personelin administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) përditësimit të të dhënave të dosjes individuale, CV dhe dokumentacionit shoqëruës;</li> <li>b) përditësimit të të dhënave të aktivitetit akademik, kërkues artistik (akt marreveshja për kohën vjetore të punës me dokumente mbështetëse), të veprimtarisë ndihmëse akademike me karakter mësimor, artistik, shkencor, etj.<sup>25</sup></li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se, Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UART dhe FM, ku ofrohet programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, siguron mundësi të posaçme në informacione e dokumente si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët, duke vënë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faqen zyrtare të UART<sup>26</sup>, për njoftimet, informacionet mbi studentet, ambientet, aktivitetet, marreveshjet, organet drejtuese, personelin akademik, njoftimet për punësim, për projektet si dhe mbi fakultetet e UART dhe Bibliotekën Shkencore të UART.</li> <li>- Sistemin PITAGORA të regjistrimit të të dhënave të studentëve për frekuentimin, regjistrimin në provimet, mënyrës së vlerësimit, paraqitjen e notave dhe gjenerimin e proces-verbaleve të provimeve dhe në veçanti për studentët, marrjen e vlerësimit në kohë reale dhe ngarkimin e rezultatit në librezën e studentit.</li> <li>- Shkëmbimit të e-maileve me Sektorin mesimor; të Kurrikulave dhe Informimit të studentëve; Drejtorinë e BNJ</li> </ul>

<sup>23</sup> Evidenca 1, fq. 95-96.

<sup>24</sup> Statuti i UART, Neni 78.

<sup>25</sup> Evidenca 1, fq 97.

<sup>26</sup> Evidenca I.I.2.2.3 Informacion zyrtar ne faqen web te Universitetit te Arteve.

	dhe Informacionit, Protokollit dhe Arkivës; me Sektorin e Statistikës dhe IT-së.								
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga vizita në UART dhe nga logimi në faqen zyrtare të tij, konstatohet se Institucioni ka integruar platformën PITAGORA dhe TEAMS që u mundëson personelit dhe studentëve forma të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbimit të informacionit.								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se Sistemi i menaxhimit i UART në FM dhe DI, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ përmes firmosjes fizike të listë prezencës së personelit akademik, çdo ditë pune pranë Sekretarisë mesimore. Ndërsa në lidhje me raportimet individuale dhe të dhënat në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese, ky monitorim realizohet përmes verifikimit të veprimtarisë akademike e administrative të personelit të UART dhe gjenerimit të raporteve në kohë reale, si përmes kontrolleve të organizuara nga organet dhe autoritetet drejtuese, ashtu edhe nepermjet raportit të përdorimit të platformës TEAMS (në rastin e periudhës Covid -19). <sup>27</sup>								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga logimi në faqen zyrtare të UART, konstatohet se Institucioni në faqen e tij zyrtare <a href="http://uart.edu.al/">http://uart.edu.al/</a> paraqet të gjithë informacionin lidhur me këtë institucion. Informacionet publikohen nga Sistemi i menaxhimit të brendshëm në dy gjuhë ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. Informacionet kryesore lidhur me strukturën e organizimit të UART, publikohen edhe në gjuhën angleze.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri IV.4 përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mesimor-kerkëimor, mbarevajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, Raporti financiar i kostove të njësisë bazë të Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve, së bashku me mbështetjen e nevojshme financiare për mbarevajtjen e programit të studimit (për të paktën një cikël të plotë studimi), përfshihej në parashikimet e Projekt buxhetit

<sup>27</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", fq.99-100. Evidenca 1.

<p>nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>afatmesëm dhe në parashikimin e përvitshëm për financimin e të gjitha programeve të kësaj njësie.</p> <p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar, burimet financiare të Njësisë Bazë DI, përlllogariteshin nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxheti i Shtetit (Granti i Politikave të Zhvillimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë; Grandi i mësimdhënies dhe Granti i Punës Kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese), dhe</li> <li>- Të ardhurat e krijuara nga institucioni.<sup>28</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të</p>	<p>Plani financiar hartohet në nivel institucional dhe nuk ka një raport të posaçëm për programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në VKM nr. 83, datë 3.2.2016, Universiteti i Arteve nuk i plotëson kushtet për kryerjen e auditimit periodik nga vetë Institucioni për shkak të mos plotësimit të kriterëve të parashikuara: <i>“që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400 000 000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre”</i>.<sup>29</sup></p> <p>Universiteti i Arteve mund të auditohet periodikisht sipas akteve ligjore në fuqi nga Institucione eprore dhe të specializuara. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, UART nga viti akademik 2019 -2020 e deri më tani, nuk i është nënshtruar ndonjë procesi auditimi.<sup>30</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Fakulteti i Muzikës, DI, konstatohet se UART e realizon kriterin e raportimit tek Njësia bazë që është DI, në lidhje me realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës për programin e studimit “Kitarë dhe Mësuesi”, bazuar në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve</p>

<sup>28</sup> . Evidenca 1.RVB e Programit ‘Kitarë dhe Mësuesi’, fq. 102-103.

<sup>29</sup> VKM nr. 83, datë 3.2.2016. Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik. fq. 2050 të Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 19, fq. 2050.  
<https://shukalb.al/wp-content/uploads/2019/07/VKM-Nr.-83-3.2.2016>

<sup>30</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, fq. 104. Evidenca 1.

	<p>përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.<sup>31</sup>Po sipas dokumentacionit të dorëzuar, UART për çdo vit shkruan Raportin Vjetor<sup>32</sup> i cili ndër të tjera përmban edhe analizën financiare. Analiza financiare ju bëhet me dije Njësive Bazë edhe për arsye rakordimi me parashikimet e vitit pasardhës. Raporti vjetor miratohej në një mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit të UART dhe i dërgohen Ministrise së Arsimit dhe Sportit.</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti i Arteve garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë, Departamentit të Interpretimit dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 80/2015 Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor;</li> <li>- Ligjin nr. 10/296, date 08.07.2010 Per menaxhimin financiar dhe kontrollin;</li> <li>- Statutin e UART.</li> </ul> <p>Garancia për qëndrueshmërinë financiare sigurohej përmes parashikimeve të: Raportit financiar të kostove të njësisë bazë, DI të Fakultetit të Muzikës, përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Projekt buxhetit afatmesëm,</li> <li>- përvitshme për financimin e të gjitha programeve të studimit pranë kësaj njësie.<sup>33</sup></li> </ul>		
<b>Konkluzione</b>	<p>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri IV.5 përmbushet plotësisht.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>

<sup>31</sup> <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/63>.

<sup>32</sup> <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

<sup>33</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, fq. 106. Evidenca 1.

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga analiza e dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion konfirmojmë se institucioni operon me procedura të mirëstrukturuara sipas legjislacionit në fuqi, konform politikave dhe në funksion të studentit. Procedurat përmbushen referuar rregullores së UART, asaj mësimore për Ciklin e dytë të studimeve dhe Planit të zhvillimit strategjik të UART. <sup>34</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konfirmojmë se politikat dhe procedurat që duhet te ndjekin kandidatët për studimet e ciklit të dytë pranë Fakultetit të Muzikës dhe DI-së, ku dhe ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Kitarë dhe Mësuesi”, që nga aplikimi për pjesëmarrje në konkurrim e deri në diplomim, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe për studentët e programit të studimit. Këto procedura janë transparente sepse publikohen në faqen zyrtare të UART dhe nuk diskriminojnë askënd pasi bazohen tek legjislacioni dhe aktet nenligjore në fuqi, si: Rregulloret, Kodi i Etikës së UART <sup>35</sup> , VKM 780 datë 26.12.2018. <sup>36</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion konstatojmë së Universiteti i Arteve harton dhe publikon përpara çdo viti akademik rregullore dhe kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve të Ciklit të Dytë Master. <sup>37</sup> Për specifikën e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” pranimi i studentëve kryhet vetëm me konkurrim. <sup>38</sup> Bashkëpunimi me strukturat e maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse, aplikohet vetëm për Programin e studimeve të Ciklit të Parë Bachelor.
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë	Nga bisedat me studentët, por dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, konstatojmë se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së

<sup>34</sup> Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2025. Evidenca I.1.1.1.3. VKM 780 datë 26.12.2018 Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotesojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL

<sup>35</sup> Kodi i Etikës së UART. <http://www.uart.edu.al/media/2020%20-%20vsa%20%2023.1%20KODI%20ETIKES.pdf>

<sup>36</sup> VKM 780 datë 26.12.2018 Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotesojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL. Evidenca II.1.6.5.

<sup>37</sup> <http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr%2019,%20Dt%2010%2003%2022%20Mbi%20Percaktimin%20e%20pikezimit%20ne%20konkurset%20e%20pranimit%20per%20vitet%20akademik%202022-2023.pdf>

<sup>38</sup> <http://www.uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASJER%202023-2024%20FM.pdf>  
<http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASTER%202022-2023%20PM.pdf>



kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	studenteve të këtij program studimi janë transparente dhe bëhen publike dhe bazohen në dy Rregulloret e institucionit. <sup>39</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Sipas Rregullores Mësimore të Ciklit të Dytë të Studimeve, në fillim të vitit akademik, të interesuarit gjejnë të specifikuar kriteret dhe udhëzimet për pranim në ciklin e dytë të studimeve. UART informon online dhe fizikisht të interesuarit. <sup>40</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, konstatojmë që Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikes dhe Departamenti i Interpretimit përcaktojnë kuota pranimi të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta apo të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. <sup>41</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Konstatuam se përpara çdo viti akademik, UART, Fakulteti i Muzikës dhe DI nëpërmjet Rregullores Mësimore të Ciklit të Dytë Master, (Neni 10/5) hartojnë dhe publikojnë përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Konfirmojmë që Universiteti i Arteve harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë mbështetur në akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi, dhe i zbaton ato me Vendim të Bordit të Administrimit të UART. <sup>42</sup> Referuar dokumentacionit të dorëzuar, UART në lidhje me rritjen e cilësisë së pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit, nuk ka aplikuar për politika të veçanta ndihmese e promovuese të programeve të studimit, pasi pranimet në Ciklin e Dytë të Studimeve Master, nuk kuptojnë një cilësi më të lartë se mesatarja dhe mban parasysh tregun e punës, i cili anon nga cilësia e të diplomuarve.
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaroi se kriteri V.1 përmbushet plotësisht.</i>

<sup>39</sup> Rregulloret e mësimore Ciklit të Dytë të Studimeve Master. Rregulloret dhe kriteret pranimi Master 2022-2023. Evidenca II.1.6.4.

<sup>40</sup> Rregulloret e mësimore Ciklit të Dytë të Studimeve Master. Rregulloret dhe kriteret pranimi Master 2022-2023. Evidenca II.1.6.4.

<sup>41</sup> <http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr%202019,%20Dt%2010%2003%202022%20Mbi%20Percaktimin%20e%20Pikezimit%20ne%20konkurset%20e%20pranimit%20per%20vitet%20akademik%202022-2023.pdf>

<sup>42</sup> Urdhëri 159, datë 09.11.2021 Përrjashtimi nga tarifa e shkollimit. Evidenca I.1.3.1.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se Institucioni ofron informacion të hollësishëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga njëri vit në tjetrin për studentët e Masterit Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”. Kjo realizohet nga Rregullorja mësimore e programit të studimit të ciklit të dytë në Nenet: 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23; dhe nga specialisti për kurrikulën dhe informimin.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në lidhje me njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, konstatohet që FM dhe DI, i njofton studentët nëpërmjet specialistit për kurrikulën dhe informimit të studentëve dhe pas konsultimit paraprak me Rregulloren Mësimore të Studimit të Ciklit të Dytë Master (Kreu IV, Nenet: 24, 25, 26, 27, 28).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga evidencat e shqyrtuara rezulton se institucioni operon me dokumente të brendshme siç është Rregullorja e programit të studimit të ciklit të II, në të cilën listohen procedurat e vlerësimit të secilit student, që nga mënyrat e të provuarit të dijes, kushtet e kalimit në vitin pasardhës e deri tek përmirësimi notave (Nenet 17 - 23). Studentët informohen rreth kriterëve të vlerësimit të dijeve të tyre edhe përmes programeve lëndore/syllabuseve <sup>43</sup> të lëndëve dhe kontaktit me pedagogun e lëndës speciale, individuale.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga bisedat me studentët konstatohet se institucioni bën njohjen e çdo studenti me procedurat që ndiqen deri në përmbushjen e diplomës apo provimit përfundimtar. Kjo procedurë bazohej në Rregulloren e programit të Studimit të Ciklit të II (Neni 30 - 36).
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e	Nga bisedat e zhvilluara me pedagogë dhe studentë rezulton se UART dhe Fakulteti i Muzikës informojnë studentët për programin Master në “Kitarë dhe Mësuesi” mbi mundësitë dhe kuotat e parashikuara nëpërmjet faqes zyrtare të UART, nëpërmjet ditëve të hapura ku studentët kontaktojnë personalisht me pedagogët kitaristë dhe nëpërmjet konsultimeve me zyrën e informimit të studentëve dhe të këshillimit të karrierës.

<sup>43</sup> Syllabuset e programit të studimit “Kitarë dhe Mësuesi”.

studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri V.2 përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga biseda e zhvilluar në institucion me studentët e kitarës konfirmojmë se ata informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” nëpërmjet programeve lëndore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” <sup>44</sup> dhe Planit mësimor <sup>45</sup> përkatës.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçërm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Konstatuam se studentët kanë dijeni për çdo disiplinë, modulet specifike, praktikën mësimdhënëse, praktikën artistike dhe detyrimet për shlyerjen e çdo programi lëndor/syllabusi. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i lëndëve, ngarkesa javore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me studentët por dhe me Sektorin e Kurikulës dhe Alumnit evidentohet se UART dhe FM informojnë studentët rreth mundësive të tyre për punësim me kohë të plotë si instrumentistë në orkestrat e ndryshme apo në: Arsimin Parauniversitar ose punësim me kohë të pjesshme si personel shtesë në institucionet e produksionit kulturor publik dhe jopublik. Rezulton se ofrohej mbështetje institucionale për orientim drejt tregut të punës, realizohej nëpërmjet projektit GRADUA, ku studentet, pas regjistrimit në platformën online GRADUA, kishin mundësi dhe kontakte të drejtperdrejta me tregun e punës. <sup>46</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	Konfirmojmë se informacioni lidhur me organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme, u vihet në dispozicion studentëve të Masterit nëpërmjet komunikimit në sekretarinë mësimore dhe faqes zyrtare të UART. Po ashtu, mbështetur edhe në specifikën e zhvillimi të lëndëve speciale në DI, ku një pedagog bën

<sup>44</sup> Syllabuset e programit të studimit “Kitarë dhe Mësuesi”.

<sup>45</sup> Plani mësimor Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”.

<sup>46</sup> Një informacion mbi projektin GRADUA në faqen zyrtare të UART. <http://uart.edu.al/index.php?id=845>

Regjistrimi online i studentëve: <https://gradua.rash.al/stud/registration/Default.aspx?codepla=1&lang=sq>

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	mësim vetëm me një student, çdo student informohej nga pedagogu i tij për gjithçka që kishte lidhje me organizimin e procesit mësimor.								
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi", u sigurohej studentëve në sistem elektronik dhe fizik. Informacioni fizik mundësohej nga organizimi brendshëm akademik e administrative nëpërmjet Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës, strukturës administrative dhe asaj ndihmës akademike. Ndërsa informacioni elektronik u mundësohej studentëve nëpërmjet mbulimit me internet dhe sistemit PITAGORA.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri V.3 përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore të FM në UART, evidentuam se Universiteti i Arteve ka statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit në fjalë. Të dhënat janë të përpunuara sipas specifikës së programit të studimit. Si nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni <sup>47</sup> , ashtu edhe nga vizita e zhvilluar në Sekretarinë mësimore, konstatojmë se numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit "Kitarë dhe Mësuesi" për tri vitet e fundit ishte: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2021-2022 është 1 student</li> <li>- Për vitin akademik 2020-2021 është 9 studentë</li> <li>- Për vitin akademik 2019-2020 është 11 studentë</li> </ul> <b>Gjithsej të diplomuar 7 studentë</b> Në Total: 21 studentë Te diplomuar 7 studentë, të regjistruar në vitin 2019-2020
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo	Vertetojmë se UART mban evidenca të plota mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqet nga programi, largimet para përfundimit të studimeve apo mospërfundimet me sukses të vitit akademik. Vizita dhe biseda e zhvilluar në Sekretarinë mësimore konfirmoi se të dhënat dokumentoheshin në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e Arritjeve <sup>48</sup> dhe sistemin PITAGORA.

<sup>47</sup> Evidenca: Të dhëna studentësh.

<sup>48</sup> Regjistri Themeltar dhe Regjistri i Arritjeve. Evidencat V.4.3.1 dhe V.4.3.2.

mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.				
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” menaxhohen nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të vetifikueshme nga personat e autorizuar. Përgjegjës për hedhjen në sistemin PITAGORA dhe përpunimin e tyre ishte sektori i Statistikës dhe Informacionit në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Muzikës.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në Rregulloren e Sektorit Mësimor <sup>49</sup> , Universiteti i Arteve mbështet me akte kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). Konfirmojmë se Sektori Mësimor, kryen kontrole periodike për verifikimin e saktësisë së informacionit në formë elektronike dhe fizike pranë Fakulteteve të Universiteti të Arteve, përfshirë Fakultetin e Muzikës, për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave, sikurse dhe kërkon infomacion nga Njësia Bazë DI për dokumentacionin e administruar prej tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konfirmojmë që në Raportin vjetor që hartohet nga DI merren në shqyrtim dhe krahasohet profili dhe cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve kitaristë. Sektori Mësimor në bashkëpunim me specialisten e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, siguronin të dhëna rreth punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Sipas dokumentit të RVEI-së, riorganizimi i Programit të Studimit Cikli i Dytë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” përmirësoi ndjeshëm treguesit e punësimit të diplomanteve kitaristë të FM. Nga studentët kitaristë janë punësuar si specialistë kitare dhe mësues në institucione publike dhe jopublike të arsimit parauniversitar, si: -Në Qendrën Performancë-3 specialist kitare -Në Qendrën Harmoni-1 specialist kitare -Në Qendrën Lincoln-1 specialist kitare Në Arsimin Publik parauniversitar: -Nëe Shkollën “Kongresi i Lushnjës”- ZVA-Lushnjë -1 mësues kitare Gjithsej 6 të punësuar.			
<b>Konkluzione</b>	Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri V.4 përmbushet plotësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet gjithësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<sup>49</sup> <http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr%2021,%20dt%2007%2010%2021>

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar takimit me studentët që studionin në DI dhe me GVB, institucioni zbaton përfshirjen e studentëve në struktura të përhershme ose ad-hoc konform detyrimeve ligjore, Statutit të UART<sup>50</sup> dhe rregulloreve të saj. Konfirmojmë se inkurajohej pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lire dhe shprehjen e mendimit të tyre, në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Senat akademik (2 studentë)</li> <li>▪ Këshillin e Etikës (1 student)</li> <li>▪ Komisionin e përhershëm të marrëdhënieve me studentët (1 student)</li> <li>▪ Këshillat studentorë</li> <li>▪ Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të akreditimit institucional</li> <li>▪ Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Evidentohet se studentët janë faktor me peshë në proceset e përmbushjes së programit. Studentët janë aktivë në vlerësimin e cilësisë së stafit akademik. Mendimi i secilit tërhiqej për vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve rreth veprimtarive mësimore, shkencore dhe artistike.<sup>51</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Konstatojmë se DI lejon përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të programit të studimit dhe reflekton sugjerimet e tyre. Në pyetësorin e zhvilluar në Maj të 2022 dhe të depozituar në dokumentacionin e këtij programi studimi, konstatuam se studentët shprehnin mendimet e tyre në lidhje me vështirësitë që ata kishin dhe jepnin sugjerime rreth çështjeve që kishin nevojë për rishikim dhe përmirësim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e</p>	<p>Nga bisedat me studentët e kitarës nuk u identifikua ndonjë rast ankimi të studentëve lidhur me kryerjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të</p>

<sup>50</sup> Statuti i UART, Neni 126.

<sup>51</sup> Rezultatet e Pyetësorit Maj 2022. Evidenca II.5.2.1.

95

kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	dijeve. Provimet me shkrim iu nënshtroheshin procesit të sekretimit <sup>52</sup> duke dëshmuar për barazi të procesit të vlerësimit dhe paanshmëri në vlerësimin e studentëve. Mundësitë për kontestim të rezultatit, ankimim të notës dhe rishikim të saj nga njësia bazë apo nga pedagogu përgjegjës, ishin të parashikuara në nenin 45 të Rregullores së Veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaroi se kriteri V.5 përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Konfirmojmë që në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, UART vë në dispozicion Sekretarinë Mësimore pranë FM, Specialisten për informimin e studentëve, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni të përfshirë në Sektorin Mësimor pranë Rektoratit të UART. Baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari është Statuti i UART.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe bisedave gjatë vizitës në institucion, konfirmojmë se për përmbushjen e këtij kriteri, përveç njësive të mësipërme të vëna në dispozicion të studentëve që bëjnë këshillimin të drejtpërdrejtë, por dhe me anë të komunikimit online (faqja zyrtare e universitetit), ndërsa lehtësimi i studentëve të kitarës gjatë procesit mësimor bëhej nga pedagogu specialist i lëndës pasi natyra specifike e programit të studimit e kërkon një gjë të tillë.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për	Nga bisedat me anëtarët e Sektorit të Kurikulës, të Alumnit konfirmojmë se informacioni i nevojshëm për këshillimin e karrierës, orientimin për praktikën profesionale dhe për në tregun e punës, studentëve kitaristë u vihej në dispozicion nga Sektori mësimor dhe specialistja për Informim dhe Këshillim Karriere dhe Alumni, si dhe nga Këshilluesi akademik ose pedagogu i lëndës specifike.			

<sup>52</sup> Sekretim provimi (foto). Evidenca III.3.2.2.

praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Grupi i RVJ-së, gjatë bisedave të zhvilluara në institucion, evidentoi se Sektori Mësimor në bashkëpunim me specialisten e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, realizonin gjurmimin e studentëve kitaristë pas diplomimit dhe siguronin të dhëna rreth punësimit të tyre. Të dhënat i vinin në dispozicion të organeve drejtuese dhe studentëve. Platforma GRADUA ishte një tjetër formë tjetër, që siguronte në mënyrë sintetike dhe elektronike të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve kitaristë.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri V.6 përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet						
			X						

## V. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Mësimdhënia dhe të nxënësit në mësimin e kitarës ka specifika të ndryshme, që nuk lidhen me një udhëzues institucional, sepse mësimi zhvillohet i individualizuar dhe metodat janë të efektshme sipas nevojave të individit/studentit. Nga bisedat me pedagogët e kitarës, por dhe sipas Rregullores së programit të studimit <sup>53</sup> treguesit e synuar për të arritur në përfundim të studimeve Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, janë individualiteti dhe origjinaliteti, ndaj theksojmë se aplikimi në mënyrë të unifikuar i planit mësimor dhe repertorit të përcaktuar varen shumë nga individualiteti dhe karakteristikat e secilit student, dhe si i tillë, nuk mund të realizohet në mënyrë uniforme. Nga ana tjetër stafi i pedagogëve që japin lëndë dhe module me grupe studentësh theksuan se përdorin

<sup>53</sup> Rregullore e programit të studimit (Neni 8).



	<p>metodologji që kanë në bazë ndërveprimin aktiv pedagog-student, por gjykojmë që duhet të ketë një udhëzues metodologjik për mësimdhënien dhe të nxënë të lëndë dhe module me grupe të mëdha studentësh.</p> <p><i>Rekomandojmë hartimin e një udhëzuesi për mësimdhënien dhe të nxënë ndërveprues.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga drejtuesi i DI-së dhe nga Grupi mësimor lëndor u konfirmua se këto njësi zhvillonin mekanizma të monitorimit dhe vlerësonin në periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik të këtij program studimi.</p> <p>Mekanizmat e monitorimit të personelit akademik përfshinin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësorët nga Sektori Mësimor dhe Fakulteti i Muzikës, të plotësuar nga ana e studentëve dhe pedagogëve dhe perpunimi i të dhënave të tyre.</li> <li>- Nënshkrimin e marrëveshjes së kohës vjetore të punës me Njësinë Bazë DI dhe përpunimit të të dhënave të aktivitetit kërkimor artistik e metodologjik pedagogjik të personelit akademik.</li> </ul> <p>Vlerësimet periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizoheshin nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizave vjetore të Departamentit të Interpretimit;<sup>54</sup></li> <li>- Analizave vjetore të Universitetit të Arteve.<sup>55</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit që UART garanton përfshirjen e studentëve kitaristë në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë edhe trajtimin e ankimeve, nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve me studentët.<sup>56</sup></p> <p>Fakti që secili student në fillim të vitit akademik nënshkruante një marrëveshje ku vetë ai shprehte dëshirën për përzgjedhjen e pedagogut të lëndës speciale, tregonte për mënyrën demokratike të përzgjedhjes dhe mundësinë që i krijohej studentit të vendoste për vazhdimësinë e studimeve për veten e tij.</p> <p>Referuar bisedave të zhvilluara me studentë të DI-së, ata ndiheshin të lirë të thonin mendimin e tyre, të ndryshonin pedagogun vitin e ardhshëm nëse nuk ishin të kënaqur, të sugjeronin zgjidhje të mundshme të problematikave me të cilat përballen çdo ditë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të Analizës vjetore të punës në UART<sup>57</sup>, konfirmojmë se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie kontribuon me të dhenat dhe rezultatet e vlerësimin në analizen vjetore të Universitetit të Arteve për monitorimin dhe sigurimin</p>

<sup>54</sup> Analiza vjetore e Departamentit të Interpretimit. Evidenca I.1.3.1.1.

<sup>55</sup> Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

<sup>56</sup> Rezultatet e Pyetësorit Maj 2022. Evidenca II.5.2.1.

<sup>57</sup> Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

	e vazhdueshem të cilësisë në mesimdhënie, si dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.						
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar <sup>58,59</sup> , evidentuam se Universiteti i Arteve, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies nëpërmjet analizave vjetore dhe konkluzioneve të tyre, me qëllim respektimin e standardeve të cilësisë si dhe përmirësimin të metodave të mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme.						
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri VI.1 përmbushet plotësisht.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi VI.2</b>	<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Konfirmojmë se Universiteti i Arteve ka hartuar politika, ka ngritur struktura dhe përcaktuar procedura për funksionimin e NJSBC në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi <sup>60</sup> , Statutin e UART <sup>61</sup> , Planin e Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve <sup>62</sup> . Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe nga vizita në FM, konfirmojmë se UART ka ngritur Komisionin e ad-hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Fakulteti i Muzikës bashkëpunon me NJSBC dhe zbaton detyrat në përputhje me Rregulloren e NJSBC-së. <sup>63</sup> Numri i anëtarëve të NJSBC përcaktohet edhe sipas Nenit 5 të kësaj rregulloreje.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për	UART, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ka ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Sipas bisedës me përfaqësues të KSBC-së, kjo njësi funksiononte si njësi që ndihmonte në organizimin e punës tek sektorët e tjerë të UART me qëllim krijimin e frymës së bashkëpunimit ndërmjet strukturave të brendshme në institucion

<sup>58</sup> Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

<sup>59</sup> Analiza vjetore e Departamentit të Interpretimit. Evidenca I.I.3.1.1.

<sup>60</sup> Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Neni 103. Evidenca I.I.1.1.1.

<sup>61</sup> Statuti i UART. Neni 135, 136.

<sup>62</sup> Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2025. Evidenca I.I.1.1.3.

<sup>63</sup> Rregullore e Funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

<http://www.uart.edu.al/media/VSA%20Nr%2024,%20dt%2007%2010%2021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rregullores%20e%20Funksionimit%20e%20Njesise%20se%20Sigurimit%20e%20Brendshem%20e%20Cilesise,%20one%20UART.PDF>

përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	dhe garantonte sinkronizim, informim periodik për çdo veprimtari të programit. KSBC tregonte një vëmendje të veçantë ndaj përfshirjes së studentëve në ruajtjen e cilësisë, si i interesuari primar i kësaj të drejtë.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti i Arteve, për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë orientohet nga Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe përdorte Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë me elementet e tij përbërës dhe Standardet e Kriteret respektive të tyre sipas Rregullores së NJSBC, Statutit të UART dhe Ligjit 80 2015. Qëllimi është përfshirja në procesin e SBC e të gjitha strukturave akademike që nga DI e deri në Rektorat, dhe studentëve. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. Bazuar në bisedën me drejtuesin e zyrës së SBC-së, UART vjen në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit pasi ka kaluar me sukses dhe ka marrë Vendimin nga BA për Akreditimin institucional <sup>64</sup> për 6 vite. Ky vlerësim i këtij programi të studimit po bëhet në kuadër të akreditimit periodik dhe UART është në fazën përmbyllëse të Vlerësimit të Brendshëm dhe në pritje të Vlerësimit të jashtëm.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Referuar bisedës me të gjithë përfaqësuesit e NJSBC-së, konstatoam se anëtarët e saj kanë njohje të detajuar të detyrës që kanë në institucion. Veprimtarinë e saj NJSBC-ja mbështetej në frymën dhe detyrimet që derivojnë nga dokumente strategjike (Statutin e UART, Planin e Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2025 dhe në Rregulloren e Funkcionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë). Pasqyrimi i gjendjes ekzistuese, arritjeve, dobësive si dhe kontrollet teknike, semestrale dhe vjetore të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, paraqiteshin në Analizat vjetore të çdo njësie (DI, FM dhe atë të UART) <sup>65</sup> . Nisur nga bisedat në institucion dhe duke marrë parasysh specifikën e këtij programi studimi, themi që promovimi i praktikave të mira realizohej nëpërmjet organizmit të koncerteve dhe skena ishte një nga treguesit më të fuqishëm të suksesit të programeve të DI në FM. Prandaj theksojmë se këto tregues në UART janë krejt të ndryshëm nga treguesit cilësorë në programe studimi të universiteteve të tjera.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri VI.2 përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<sup>64</sup> Vendimi i BA për Akreditimin institucional, Nr. 17. date 24/03/2022. <https://www.asc.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-24-mars-2022>

<sup>65</sup> Analiza vjetore e Departamentit të Interpretimit. Evidenca I.I.3.1.1 në AMS. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore, Artistike-Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. Viti akademik 2020-2021. <http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf>

Standardi VL3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson nëpërmjet njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit është njësia bazë që merr në shqyrtim për rishikim dhe mbikëqyrje periodike të programit nga plani deri tek syllabueset. Konfirmojmë që FM dhe DI përdorin dy mekanizma kryesorë për analizimin dhe dokumentimin e ecurisë së programit të studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raportin e Analizës vjetore të DI, e cila pasi diskutohet në rang departamenti, i përcillet dekanit të FM dhe më pas Rektoratit.</li> <li>2. Pyetësorët, të cilët organizohen në nivel Fakulteti dhe Universiteti.<sup>66</sup></li> </ol> <p>Një tregues tjetër i ecurisë së këtij program studimi është edhe suksesi në koncertet që organizon FM. Duke marrë në konsideratë specifikën e programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi”, konfirmojmë që kjo specifikë lidhet drejtpërsëdrejti me produktin konkret, artistik. Studentët e këtij programi studimi, i nënshtroheshin vazhdimisht vlerësimit të publikut, i cili është një ndër treguesit kryesorë të arritjeve të këtij programi. Të gjitha rezultatet e vlerësimeve pasi dokumentohen, ndiqnin rrugën institucionale dhe u bëheshin të njohura strukturave përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit, në përfundim të çdo viti akademik, harton raportin e Analizës vjetore (të përmendur më sipër) në të cilën adresohen të gjitha problematikat si dhe vlerësohen arritjet pozitive. Po ashtu adresohet dhe motivimi për arritje me të mira në mësim e kërkim artistik nga personeli akademik dhe studentët. Konstatuam që një raport i tillë është Analiza vjetore 2021-2022 e DI-së. Raporti evidentonte arritjet e objektivave didaktike dhe artistike si për personelin akademik ashtu edhe për studentët. Motivimi i madh për studentët e këtij departamenti dhe fakulteti, ishin numri i madh i koncerteve të organizuara në periudhën Prill-Qershor 2022 (60 të tilla) në kuadër të 60 vjetorit të krijimit të Fakultetit të Muzikës, ku 90% e pjesëmarrësve ishin studentë dhe pedagogë nga departamenti i Interpretimit. Adresimi i numrit të kufizuar të projekteve kërkimore dhe shkencore të stafit akademik, konfirmon edhe njëherë specifikikën veçantë të Fakultetit të Muzikës, i cili nuk funksionon si fakultetet e tjera. Sipas bisedave të qëllimta me anëtarët e DI dhe me komisionin e NJSBC, dhënia e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve, ia bëri të mundur njehsimin e një aktiviteti artistik me një aktivitet</p>

<sup>66</sup> Rezultatet e Pyetësorit Maj 2022. Evidenca II.5.2.1.

	shkencor, pasi sukcesi i arritjeve të stafit akademik të këtij fakulteti matet me numrin e koncerteve dhe aktiviteteve artistike që organizon.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar<sup>67</sup>, konfirmojmë që UART përdor këto të dhëna për vlerësimin e programit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitorim të procesit të mësimdhënies;</li> <li>- Vlerësim të lëndëve nga studentët;</li> <li>- Rezultatet në provime të studentëve;</li> <li>- Rezultatet e studentëve në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit;</li> <li>- Rezultatet në aktivitetet artistike;</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;</li> <li>- Testimet lokale të kryera për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit;</li> <li>- Rezultatet e punimeve të diplomave.</li> </ul> <p>Përveç këtyre, ftohen në takime për të diskutuar edhe pedagogë të jashtëm, të cilët ofrojnë ekspertizën për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>Gjatë bisedave të realizuara me persona sipas agjendës së vizitës, konfirmojmë që vlerësimi i programit bëhej periodikisht. Për këtë, aplikoheshin metodologji mikse.</p> <p>Ndër metodat e tërthorta që përdorte DI-ja, ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i pedagogëve të DI-së për cilësinë e programit të studimit. Duke qenë se UART është një universitet me status të veçantë, ky vetëvlerësim merr një rëndësi të veçantë për vetë specifikën që mbart.</li> <li>- Vlerësimi i numrit të stafit akademik të punësuar pranë DI-së. Konstatohet se përqindja më e madhe e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në DI, janë diplomantë të UART sipas programeve specifike, dhe ky është një tregues sukcesi.</li> <li>- Ndjekja e ecurisë artistike të studentëve të diplomuar pranë këtij universiteti. Ndjekja e karrierës së studentëve të UART pas diplomimit, konfirmon se një pjesë e mirë e tyre kanë një karrierë ndërkombëtare.</li> <li>- Punësimi i alumnit i DI-së, pranë institucioneve publike artistike dhe kulturore si orkestra, shkolla të mesme artistike Tiranë dhe rrethe, në televizionin shtetëror dhe televizione private, etj., dëshmon për suksesin e arritur te këtij departamenti.</li> <li>- Raporti: të diplomuar-të punësuar. Ky raport, në periudhën e akreditimit të programeve, rezultoi shumë i kënaqshëm. Nga 4</li> </ul>

<sup>67</sup> UART, Raport i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Ciklit të Dytë, Master i Arteve 'Kitarë dhe Mësuesi', fq. 135. Evidenca 1.

	studentë të diplomuar, 3 prej tyre ishin punësuar në specialitetin primar.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaroi se kriteri VI.3 përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<b>Standardi VI. 4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë bisedës me grupin e NJSCB-cë dhe shqyrtimit të dokumentacionit, evidentuam se: në funksion të garantimit të vijueshëm të cilësisë së programit, janë të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Një pjesë e bashkëpunimeve në kuadër të rritjes së cilësisë, ishin bashkëpunimet me punëdhënësit gjatë zhvillimit të praktikave mësimore pranë tyre. Statuti i UART dhe Rregullorja e NjSBC-së garantonin pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për këtë qëllim.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Funksioni kryesor i NjSBC-së është sinkronizimi i veprimtarisë së çdo njësie që garanton sigurimin e cilësisë. Konfirmojmë se në funksion të cilësisë ka detyrime dhe përgjegjësi konkrete institucionale për çdo strukturë akademike dhe administrative, si përfaqësues të studentëve: departament, koordinator i programit, zyra e karrierës, sekretaria mësimore dhe stafi akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Njësia kryesore përgjegjëse për SBC është njësia bazë e secilit fakultet në UART. Konstatojmë se DI në Analizën e saj vjetore evidentonte pikat e forta dhe ato që kishin nevojë për përmirësim nëpërmjet përfshirjes së gjithë anëtarëve të këtij departamenti, personelit ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe studentëve. Kjo përfshirje garantohej nëpërmjet dokumentëve startegjik të FM.
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, konstatojmë se Urdhri i lëshuar nga dekani i Fakultetit të Muzikës për ngritjen e grupit të punës për

103

integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	realizimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm <sup>68</sup> , parashikonte përfshirjen e përgjegjësit të Njesisë Bazë DI, kryetarëve të grupeve mësimore, përfaqësuesit të administratës dhe të një studenti, duke mos lejuar asnjë mundësi diskriminimi apo pabarazie.								
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Konfirmojmë se pjesë e proceseve të garantimit dhe vlerësimit të cilësisë janë edhe stafi akademik i jashtëm. Po ashtu, sipas RVB-së, mundësia e zhvillimit të masterklasave me pedagogë të huaj nga institucione homologe nga Europa, bënte të mundur sigurimin e ekspertizës nga ekspertë të huaj për cilësinë e programit. Kjo lejonte bërjen e krahasimit të metodologjive dhe dhënien e sugjerimeve përkatëse. Shkëmbimet Erasmus + <sup>69</sup> si në mobilitetin e stafit të brendshëm akademik, ashtu edhe nga mobiliteti i studentëve, ishin një tjetër mundësi për përmirësime në këtë program studimi.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri VI.4 përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Çdo veprimtari e inicuar nga KSBC është publike për studentët dhe të interesuarit. Veprimtaritë në funksion të garantimit të cilësisë mbështeten nga statuti dhe rregullorja e institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Konstatojmë se me përfundimin e procesit të akreditimit, UART shpall në faqen zyrtare të tij vlerësimin përfundimtar dhe janë konform legjislacionit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe të dhënat personale. <sup>70</sup>

<sup>68</sup> Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë Master. Evidenca II.5.1.7.

<sup>69</sup> Shkëmbimet Erasmus+ (foto). Evidenca I.1.2.5.2.

<sup>70</sup> <http://uart.edu.al/index.php?id=1109>

legjislacionin për të dhënat personale.							
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Konfirmojmë që raportet e vlerësimit në UART përmbajnë çështje që kanë nevojë për përmirësim dhe dalin me rekomandime konkrete për këto çështje. Në dokumentin “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Arteve” parashikohet që të krijohet një plan masash për zgjidhjen e rekomandimeve të bëra nga ky dokument. <sup>71</sup> <i>Nuk konstatoam se ka një plan masash ku adresohen përmirësime specifike apo të përgjithshme të problematikave të evidentuara.</i>						
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Si ekip i RVJ besojmë se efektiviteti, ndikimi dhe monitorimi nga KSBC në funksion të përmirësimit të cilësisë së këtij program studimi është në nivelin e duhur.						
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga diskutimet e zhvilluara në takimet e drejtpërdrejta me anëtarët e KSBC dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të RVB-së rezulton se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.						
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, GVJ deklaron se kriteri VI.5 përmbushet plotësisht.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<sup>71</sup> Vendim nr. 17, datë 24.03.2022 Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Arteve.  
<http://uart.edu.al/media/Vendim%20i%20BA%2017%202022>



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve/Fakulteti i Muzikës/Departamenti i Interpretimit”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Konfirmojmë se Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” është hartuar dhe riorganizuar sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe mund të ndiqet vetëm në Fakultetin e Muzikës pranë Universitetit të Arteve në Tiranë.
2. Programi i studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” i formon profesionalisht studentët kitaristë veçanërisht nga ana artistike dhe kulturore, por edhe nga ana pedagogjike përsa i përket ushtrimit të tyre në të ardhmen të profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar.
3. Personeli akademik që mbulon këtë program studimi është mbi 90% staf i brendshëm dhe shumë i kualifikuar, me tituj dhe grada akademike dhe me përvojë shumë vjeçare në orkestrën e TKOB, muzikë dhome e solo, duke siguruar përmbushjen ligjore të këtij kriteri dhe suksesin e këtij programi studimi.
4. Biblioteka e UART është e vetmja bibliotekë arti në Shqipëri, e cila me fondin e saj shkencor, muzikor, artistik dhe historik, ofron për studentët kitaristë një katalog shumë të pasur me vepra të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj. Pasurimi i kësaj biblioteke me Katalogun e Shtëpisë së famshme gjermane Henle Verlag ofron për studentët e Fakultetit të Muzikës dhe veçanërisht të studentëve kitaristë një mbështetje të madhe nëpërmjet opusit të veprave për kitarë solo, në ansambël dhe parte orkestrash.
5. Aksesimi online dhe pa pagesë e studentëve kitaristë në katalogun online të BSHUA dhe në International Library Petrucci – IMSLP, lejon marrjen në formate digjitale të fondit historik dhe arkivin e këtyre bibliotekave.
6. Punësimi i shumë të diplomuarve të programit të studimit Master Profesional në “Kitarë dhe Mësuesi” si specialistë në institucione të ndryshme arsimore, jopublike dhe si mësues në shkolla publike janë një tregues cilësor i suksesit të këtij programi studimi.
7. Provovimi i fuqishëm i studentëve kitaristë bëhej nga vetë Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit dhe realizohej nëpërmjet daljes në skenë dhe performimit të studentëve përkrash pedagogëve të tyre në koncerte të ndryshme.

**Pika të dobëta**

1. Prurjet nga shkollat e mesme aritistike janë me nivele artistike jo të kënaqshme për shkak të mungesës së mësimin të kitarës në disa shkolla artsitike, por dhe për shkak të ndarjeve të nxënësve në këto shkolla në studime të instrumenteve apo profileve të tjera, artistike në fushën e muzikës.

**Rekomandime**

1. Rekomandohet që në nivel fakulteti dhe departamenti të hartohet një strategji afatmesme (me objektiva të matshëm dhe veprimtari konkrete dhe të buxhetuar nga institucioni) për një bashkëpunim dhe

bashkëndim më të efektshëm me shkollat artistike (9-vjeçare dhe të mesme), por dhe shkolla të mesme të llojeve të tjera, lidhur me:

*a-Mbështetjen e nxënësve që studiojnë kitarë në shkollat e artistike për të rritur numrin e tyre*

*b-lidhjen me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të tjera për identifikimin e taleneteve në fushën e instrumentit kitarë, por dhe për intrumente të tjera, muzikore.*

2. Rekomandohet që ekipi i pedagogëve që realizojnë mësimdhënie në grupe të hartojnë një Udhëzues për Mësimdhënien dhe të Nxënët Ndërveprues, ku të paraqiten praktikat e mira që pedagogët zhvillojnë në procesin mësimor.
3. Rekomandohet që të rishikohet Plani Mësimor i programit të studimit “Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi”, nga pikëpamja e shpërndarjes së ngarkesës mësimore të shprehur në kredite për kategoritë A dhe C, me qëllim që të pajtohet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar).

### **Evaluations conclusions for the second cycle study program Master of Arts in “Guitar & Teaching” / provided by the Higher Education Institution “Arts University of Tirana”**

#### **Strengths and considerations**

1. We confirm that the Master of Arts study program in "Guitar and Teacher" has been designed & developed according to the legal requirements in force and can only be followed at the Faculty of Music at the University of Arts in Tirana.
2. The Master of Arts study program in "Guitar and Teacher" professionally forms guitarist students especially from the artistic and cultural side, but also from the pedagogical side in terms of their future exercise of the teaching profession in pre-university education.
3. The academic staff covering this study program is over 90% internal and highly qualified staff, with academic titles and ranks and with many years of experience in the TKOB orchestra, chamber and solo music, ensuring the legal fulfillment of this criterion and the success of this study program.
4. The UART library is the only art library in Albania, which with its scientific, musical, artistic and historical fund offers guitarist students a very rich catalog of works by Albanian and foreign composers. Enriching this library with the Catalog of the famous German ‘Henle Verlag’ House offers the students of the Faculty of Music and especially the guitarist students a great support through the opus of works for solo Guitar, ensemble and orchestral parts.
5. Online and free access of guitarist students to the BSHUA online catalog and to the Petrucci International Library – IMSLP, allows receiving in digital formats the historical fund and archive of these libraries.



6. The employment of all graduates of the Master of Arts study program in "Guitar and Teacher" as instrumentalists in various orchestras and Ensembles, as specialists in cultural production institutions are a qualitative indicator of the success of this study program.

7. The strong promotion of guitarist students it's realized by the Faculty of Music and the Department of Interpretation through the appearance and performance of the students alongside their pedagogues in various concerts.

### **Weak points**

1. Students coming from secondary artistic schools have unsatisfactory artistic levels due to the lack of Guitar lessons in some artistic schools, but also due to the division of students in these schools into studies of instruments or other profiles, artistic in the field of music.

### **Recommendations**

1. It is recommended that at the faculty level and the Department of Music and Instruments, a medium-term strategy (with measurable objectives and concrete activities budgeted by the institution) be drawn up for a more effective cooperation and coordination with artistic schools (9-year and high school) ), but also secondary schools of other types, related to:

a-Supporting pupils studying the Guitar in artistic schools to increase their number

b- the connection with 9-year and other secondary schools for the identification of talents in the field of the Guitar instrument, but also for other musical instruments.

4. It is recommended that the team of pedagogues who teach in groups draft a Guide for Interactive Teaching and Learning, where the good practices that pedagogues develop in the teaching process are presented.

5. It is recommended to revise the Academic Plan of the study program "Professional Master in Guitar and Teacher", from the point of view of the allocation of the academic load expressed in credits for categories A and C, in order to comply with the provisions of VKM no. 41, dated 24.01.2018 (amended).

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushjen plotësisht	Përmbushjen kryesisht	Përmbushjen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X